

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7586 E enjte 12 Korrik 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga VASIL KURETA

Përballë "Amerika First"
dhe Europa e Bashkuar



Ka tashmë, jo thjesht një opinion, por një bindje se SHBA do të aplikojë edhe në marrëdhëniet me aleatët natyrorë evropianë, principin apo filozofinë ...
Vijon në faqen 20-21

Opinion

Ditës

Nga "ZËRI I AMERIKËS"

Shqipëria, furnitorja më e madhe e Europës me hashash



Shqipëria është vendi i origjinës së shumicës së sasive të marijuanës që kanë si destinacion tregjet italiane dhe evropiane", pohimi vjen nga Drejtoria Qendrore ..
Vijon në faqen 21



Alarmohet Athina, KE "rregullon" deklaratën

Komisioneri Han: Ristrukturim të kufijve mes Greqisë dhe Shqipërisë

Rama në samitin e NATO-s: Morëm vlerësim pozitiv. "Pakti detar"? Kapërcejmë të kaluarën

Komisioneri i BE për Zgjerimin, Johannes Hahn, ka bërë një deklaratë në një konferencë për shtyp nga Londra, e cila është diskutuar gjatë në mediat greke. Hahn ka thënë se Shqipëria dhe Greqia po shkojnë drejt një marrëveshjeje për rindërtimin e kufijve. "Unë mendoj se ne kemi parë vendime prej burrash shteti si për shembull për ...
Në faqen 4

ARRESTOHEN OFICERI DHE AVOKATI, U MERRNIN PARA QYTETAREVE PER GJYQET

"PROKURORJA KERKON 2 MIJE EURO", PERGJIMET E POLICIT

Pazaret për proceset gjyqësore, zbardhet biseda mes Haki Dylit e Devis Qanës. Çështja u denoncua nga kryetarja e gjykatës së Durrësit, Joana Qelesi



(Në foto) Gjykata e Rethit Durrës

Në faqen 8

FSHEHU DENIMIN

Prokuroria nis hetimet për gjyqtarin Admir Thanza

Në faqen 9

KONTROLLET

30 milionë lekë gjoba për 870 subjekte, s'dhanë kuponin tatimor

Në faqen 7

FLET MJEKU

Ylli Merja: Ja ushqimet që përdoren për të kuruar gastritin

Në faqen 11

ELIMINOHET ANGLIA

120 minuta "luftë", Kroacia është finalistja e dytë e Botërorit

Në faqen 22

RAPORTIMI PER VITIN 2017



Arta Marku: Në kohën e Liallës u hetuan vetëm 12 zyrtarë të lartë

Në faqen 3



Rrëfimi i këngëtares: S'bëj kompromis për famë ndërkombëtare

Orgesa Zaimi: Fëmijët i lija dhe i gjeja në gjumë

Në brendësi: Luana "çmend" ndjekësit. Era Istrefi bën nxemje për finalen

Nga EGLA XHEMALI

Orgesa Zaimi është një nga zërat më të mirë të muzikës pop-rrok në Shqipëri. Këngëtarja vjen në një rrëfim për suplementin "Summer Pages", ku na tregon për pushimet e kësaj



vere, raportet me fëmijët, për muzikën e radion si dhe për projektet më të afërta. Në këto ditë të nxehta këngëtarja na thotë se përpos pushimeve në Borsh, do të jetë e angazhuar me muzikë. E pyetur nëse ka vendosur të jetë e rreptë ...

Suplement

"DREJTËSIA" DEBATI

Ministria e Drejtësisë, para deputetëve: Urgjencë, të miratohet ligji për Magjistraturën

Gjonaj, kritika prokurorisë: Pengoi hetimet dhe vetingun

Braho: Prokurorët kanë dredhur zinxhirin?

Valentina Madani

Ministria e Drejtësisë, Etilda Gjonaj kërkoi dje që të miratohen dy ligjet për Shkollën e Magjistraturës dhe emërimin e magistratëve të rinj. Gjonaj tha se pa miratimin e këtyre ligjeve për të cilat kërkohen 84 vota në parlament është e pamundur që Shkolla e Magjistraturës të hapë vitin e ri akademik. Deklaratat e saj u bënë gjatë raportimit vjetor në Komisionin e Ligjeve. "Për sa i përket ligjit të Shkollës së Magjistraturës, ju keni qenë prezentë këtu, ministri i Drejtësisë ka autorizuar zv/ministrin të jetë prezent gjatë diskutimeve për ligjin. Ka shumë rëndësi që të zgjidhen të dyja çështjet që kanë të bëjnë me ndryshimet e propozuara. E para që t'i jepet mundësia Shkollës së Magjistraturës që të hapë vitin e ri shkollor, ku ne themi që po heqim nga sistemi gjyqtarë dhe prokurorë të korruptuar dhe t'u jepet mundësia të hyjnë në këtë shkollë. Nëse ky ndryshim ligjor nuk miratohet, atëherë është e pamundur që Shkolla e Magjistraturës të hapë vitin e ri akademik dhe e dyta ka të bëjë me kategorinë e kandidatëve për magistratë që kanë mbaruar studimet këtë vit. Në konsideratat e mia, jo vetëm që është e ligjshme, por duhet patjetër kur gjyqtarë dhe prokurorë po na dalin nga sistemi ose duke dhënë dorëheqjen apo nuk kalojnë procesin e vetingut. Nga propozimet nuk ka asnjë risi, thjesht kërkohet të shqyhet periudha tranzitore e shtjrit për t'u zbatuar dhe priten e ngritjes së institucioneve të reja", theksoi Gjonaj. Gjatë raportimit në Komisionin e Ligjeve ministria e Drejtësisë, Etilda Gjonaj foli mbi mënyrën e zbatimit nga organi i prokurorisë të rekomandimeve prioritare të dhëna nga Këshilli i Ministrave në luftën kundër krimit të organizuar gjatë vitit 2017. Ajo hodhi kritika mbi prokuror-



Komisioni parlamentar i Ligjeve

KRIKITA

"Vlen të theksohet se Drejtoria e Inspeksionit për gjatë 2016 nuk ka ekzistuar, duke krijuar një vështirësi dhe duke ndikuar negativisht dhe në procesin e vlerësimit profesional të prokurorëve. Kjo deri në shkurt të 2018 kur rezultojnë se KPK nga prokuroria ishin dorëzuar raportet vetëm për 24 subjekte, duke sjellë vështirësi në procesin më të rëndësishëm, në procesin e vetingut", - tha Gjonaj.

PD-LSI, kallëzim Ramës: Prova që ka për audiopërgjimin e Agron Xhafajt, vepër penale

Dy kryetarët e grupeve parlamentare të dy partive të mëdha të opozitës kanë depozituar një kallëzim penal në Prokurorinë e Krimeve të Rënda ndaj kryeministrit Edi Rama në lidhje me audiopërgjimin për vëllain e ministrit të Brendshëm. Kreu i grupit të PD, Edmond Spaho tha se opozita kërkon hetim penal ndaj Ramës për shkak të pengimit të zbulimit të së vërtetës, ndërsa kreu i grupit të LSI, Petrit Vasili, u shpreh se në vend ekzistojnë dy prokurori, ajo ku u bë kallëzimi penal dhe prokuroria e Edi Ramës. "Ne ju drejtuan prokurorisë të hapë hetim penal kryeministrit ndaj Edi Ramës për pengim të



vërtetës, duke mos dorëzuar provën në fjalë, ekspertimin që ai ka bërë në një periudhë aq të shkurtër kohore në një nga laboratorët e botës", - tha z. Spaho. Kurse z. Vasili u shpreh: "Kjo është një nismë e përbashkët e jona për të

ndarë qartë prokurorinë para të cilës janë të bartarët shqiptarët nga prokuroria paralele e kryeministrit. Ky kallëzim sot vë përpara opinionin publik që në Shqipëri funksionojnë dy prokurori, kjo prokurori ku kemi ardhur sot të bëjmë kallëzimin penal dhe prokurorinë e kryeministrit që ka bërë hetimin, ka bërë ekspertizë, ka nxjerrë edhe rezultate që i ka bërë publike, dhe mbi bazën e të cilave mban në këmbë qeverinë e tij. Pasi ka thënë qartë se e kreu ekspertizën, mora rezultatit, ishte e manipuluar dhe në bazë të kësaj po i jap vullnet ministrit të Brendshëm të vazhdojë detyrën".

inë, pasi sipas saj ka sjellë pengesa në procesin e vetingut. Ministria në fjalën e saj e vendosi theksin te hetimet pro aktive nga prokuroria, që sipas saj kanë qenë shumë të vogla. Ministria tha se nga të gjitha hetimet në total për 2017, vetëm 0.33% e të numrit total (140 raste) kanë qenë pro aktive dhe nga këto, vetëm 46 për korruption.

Gjithashtu, ministria akuzoi ish-Prokurorin e Përgjithshëm Lllalla se me mos funksionimin e njësisë së inspeksionit të prokurorisë u bllokua vetingut. Në pikën e hetimeve pro aktive, u ndal edhe deputeti i PS, Braho, i cili ngriti pyetjen se çfarë kanë bërë prokurorët? "Çfarë kanë bërë këta prokurorë kanë dredhur zinxhirin, këto shi-

fra kanë qenë edhe më parë, nuk ka funksionuar një drejtim i rëndësishëm i punës së prokurorisë, hetimi pro-aktiv. Zonja ministre, më dëgjo, më shiko në sy, kush do i bëjë hetimet pro aktive, nëse nuk i bën Prokuroria e Përgjithshme. Ke ndonjë mendim?", deklaroi z. Braho. Ministria u përgjigj duke thënë se situata me hetimet

BALLA: DO ZBARDH SHPIFJET E BASHES

Kreu i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla, depozitoi dje në Prokurorinë e Tiranës parashtrimet dhe fakte të reja, në plotësim të kallëzimit penal datë 27.06.2018, ndaj kreut të PD-së, Luzlim Basha për disa vepra penale. Balla shpreh bindjen se, "këto hapa ligjore do të zbardhin shpifjet dhe ofendimet e turpshme të esadistit Luzlim Basha, ndaj meje dhe ndaj gjithë grupit tim parlamentar". Sipas tij, në fund të këtij procesi shefi i opozitës do të marrë dënim shembullor dhe e vërteta e 3.4 min eurove në 'Toyota' Yaris do të zbardhet.

LSI, Rrokaj: Arsyet pse duhet një qeveri me bazë të gjerë

Deputeti i LSI, Shezai Rrokaj thotë se duhet një qeveri stabiliteti me bazë të gjerë, pasi reforma në drejtësi sipas tij, ka paralizuar disa institucione kushtetuese dhe po jep shenja të dukshme njëanshmërie. "Ja pse duhet një qeveri Stabiliteti me bazë të gjerë. Reforma në drejtësi ka paralizuar disa institucione kushtetuese dhe po jep shenja të dukshme njëanshmërie. Se dyti, mosdëshkrimi i peshqve të mëdhenj që nga ministrat e deri te bosët e drogës, si rasti i Maminasit e "Toyota" Yaris-is. Së treti, varfëria ekstreme, ku rreth 50% e popullsisë jetojnë me nën 5\$ për frymë në ditë si dhe rritja e pabarazisë sociale. Së katërti, mungesa e investimeve të huaja serioze dhe tendenca në rritje e biznesit vendas për të investuar jashtë. Së pesti, përqendrimi i parasë publike te një grupit oligarkësh, duke deformuar rregullat e konkurrencës me skema e dyshimta si ajo e PPP-ve. Së gjashti, braktisja e vendit sidomos prej popullsisë aktive për shkak të papunësisë, rrogave të ulëta, rritjes së taksave dhe dëshpërimit që ka shpënë në mungesën e besimit. Së shtati, mungesa e dialogut politik prej arrogancës së mazhorancës dhe kontrolli i mediave nëpërmjet kapesja a presionit të saj mbi to. Në këto kushte zgjedhjet vendore janë të pamundura", -tha deputeti i LSI.

pro aktive është dramatike, ndërsa kërkoi që të fillonte hetimi disiplinor ndaj prokurorëve. "Ish-Prokurori i Përgjithshëm nuk e konsideroi të rëndësishëm inspeksionin në një kohë që ligji e thotë qartë që prokurori dhe KLD kanë kompetenca, MD jo. Drejtoria e inspeksionit duhet të vijonte, pasi solli ngërç të madh. Për hetimet

pro aktive është situatë dramatike, pasi prokuroria ka pasur të gjitha mundësitë që të ndërmarrë hetime pro aktive. 0.33% e të numrit total, vetëm 1/3 ishte për çështjet e korruptionit. Arsyja do të thotë është mungesë e ushtrimit të detyrës dhe ata prokurorë dhe seksioni disiplinor të fillojë hetimin", deklaroi ministria Gjonaj.



Valentina Madani

Kryeprokuroria e Përgjithshme e Përkohshme, Arta Marku raportoi dje për rreth tri orë në Komisionin e Ligjeve për veprimtarinë e institucionit për vitin 2017. Seanca nisi me debate, që kur kreu i komisionit, Ulsi Manja bëri prezantimin e Markut si Prokurorë e Përgjithshme, tagër që sipas opozitës nuk e ka. Mbledhja filloi dhe u mbyll me debate të forta e akuzat nga PD në drejtim të kryeprokurores. Opozita fillimisht kërkoi shprehjen e raportimit me arsyetim se ishte shkelur rregullorja sepe nuk ishte në kalendar, por në fund u arrit konsensusi që raportimi i Markut të realizohej secënç e djeshme. Deputeti Flamur Noka ngriti tonet teksa e quajti Markun "prokurorin private të PS". "Nuk ka të drejtë për emërim. Zonja të mos vijë këtu për hartime, merreni tek partia prokurorin private, atje të lexojë hartime. Duhet të raportojë pse e mbylli çështjen e Saimir Tahirit? Pse nuk u apeluua vendimi i Xibrakës, ka familjarë të kryeministrit të përfshirë? Pse dështoi hetimi për 613 kg kokainë në Durrës?", - deklaroi Noka. Deputeti i PD-së, Edi Paloka i drejtoi kryeprokurores Arta Marku disa pyetje për çështjet më të nxehta si ajo për Agron Xhafajn, lëvizjet e prokurorëve që heqin çështjen "Tahiri", etj. Deputeti demokrat, Paloka tha se kryeprokuroria nuk u ktheu përgjigje pyetjeve, kurse kreu i komisionit, Manja u shpreh se komisioni ishte kthyer në "livadh". Zj. Marku tha se kishte zbatuar ligjin dhe dispozitat kalimtare për lëvizjet në prokurori, ndërsa theksoi se nuk kishte informacion për çështjet gjyqësore. Kryeprokuroria Arta Marku deklaroi se në vitin 2017 prokuroria ka hetuar vetëm 17 banda dhe 12 zyrtarë të lartë. Shefja e akuzës tha se ka mjaft probleme për hetimin pasuror, ndërsa po përgatit një udhëzim për të gjithë prokurorët se si duhet të veprojnë. Pas përfundimit të raportimit, Marku u pyet nga deputetët e opozitës për disa çështje të ndryshme në muajt e fundit, dosja "Tahiri", "Xhafaj" dhe të tjera, por kryeprokuroria u shpreh se nuk ka dijeni. "Sikur konstatohet edhe nga ju, pyetjet nuk kanë lidhje me raportin. Unë jam për të prezantuar raportin, megjithatë disa përgjigje do u jap. Sikur jeni në dijeni, me reformën e re prokuroria ka pësuar ndryshime për organizimin, një i centralizuar është bërë i decentralizuar. Prokurori mund të fillojë hetime kryesisht, ta ndjekë dhe zgjidhë dhe vetëm gjykata e kontrollon ligjshmërinë. Ndërrhyret e mia në çështjet konkrete m'i ndalon ligji dhe çështjet që ju pyetët janë të karakterit konkret, për ministër, për deputetë. Nuk kam detyrim ligjor të kem një informacion të tillë. Unë nuk kam dijeni dhe informacion dhe detyrim ligjor ka kem një

Kryeprokuroria 3 orë të "Ligjet", opozita nuk e njeh si Prokurorë të Përgjithshme

Marku raporton para Kuvendit, "plas sherri" shumicë-opozitë

Noka ngre tonet, Marku: Jeni të lodhur



Prokuroria e Përgjithshme e përkohshme, Arta Marku

informacion të tillë. Përsa i përket Agron Xhafajt, nuk kam tagër për të pasur informacion konkret. Asnjë pro-

kuror nuk mund të vijë të japë informacione konkrete, me përjashtim të komisioneve hetimore", deklaroi Mar-

RAPORTI

"Lidhur me luftën antikorruptive, gjatë 2017-ës ka pasur 12 procedime penale, 6 për zyrtarë të lartë dhe 6 prokurorë e gjyqtarë. Nga Krimet e Rënda janë kryer hetime pro aktive për 11 procedime penale. Për 2017 për korrupton, prokuroria ka regjistruar 124 procedime penale. Nga 2017 ka pasur 17 procedime për banda dhe organizata kriminale, 16 për grup të strukturuar, ndërsa në 2016, 17 për këtë vepër", - tha Marku.

dimet janë certifikuar nga KPK. Ish-ministri i Drejtësisë, Naço e pyeti nëse ministria Gjonaj është thirrur në Prokurorinë e Përgjithshme për rastin e ekstradimit të Nazer Seitit në Itali, i cili bën pjesë në dosjen "Habllaj". Gjatë raportimit nuk kanë munguar edhe diskutimet në komision, ndërsa Marku u është drejtuar deputetëve: "E shoh që jeni lodhur, por prokuroria ka punë". Por replikat mes deputetëve të shumicës e opozitës, akuzat e Flamur Nokës se është një PPP (prokurorë private politike) dhe fyerjet e deputetit të PD, Balliu ndaj Arta Markut detyruan kryetarin e komisionit, Ulsi Manja të mbyllte mbledhjen.

Kryemadhi: LSI, kurrë pjesë e pazareve për të shpëtuar Ramën

Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi, siguroi dje se LSI nuk do të ketë asnjë marrëveshje apo bisedime me mazhorancën sa i përket bashkimit të votave për votimin e ligjit të magistraturës. Sipas saj, "LSI ka qenë dhe do të jetë pro dhe pjesë e çdo takimi apo tryeze që trajton diskuton përmirësimin e jetës së shqiptarëve dhe largimin e klikës së Edi Ramës". "Asnjë marrëveshje apo bisedime nuk ka dhe nuk do të ketë për t'i zgatur agoninë kësaj qeverie, që e zhytur në krim, trafikë të paligjshme dhe korrupton po përpiqet, që në grahamet e fundit, të mund të shpëtoje me manipulime të tilla. Çdo përpjekje tjetër për ta përfshirë LSI në bisedime është thjesht pjesë e fantazisë së sëmurë të Edi Ramës, që sot më shumë se kurrë është i gatshëm të blejë e të shesë çdo gjë e çdokënd në emër të pushtetit, por që duhet ta ketë më shumë se kurrë të qartë, se për të shpëtuar karrigen e tij nuk do të ketë kurrë ndihmën e LSI", shkruan Kryemadhi. Kryetarja e LSI thotë më tej se partia që ajo drejton do të vazhdojë të jetë pjesë e opozitës së bashkuar. "Me qëllimin e qartë dhe të saktë, largimin e pushtetit banditesk të Edi Ramës! Të shpëtosh sot Edi Ramën do të thotë të shkatërrosh përfundimisht të ardhmen e shqiptarëve dhe këtë mëkat LSI nuk e merr në kurriz", tha Kryemadhi.

DEBATET TE "LIGJET", NGA BATUTAT ME LIVADHE, DERI TEK AKUZAT PER KRIMIN

Edi Paloka: Me çfarë tagri e keni thirrur zonjën, sapo përmendët titullin Prokuror i Përgjithshëm. Është një titull që nuk e ka zonja, me gjithë dëshirën tuaj të madhe. Spartak Braho: Kryeprokuroria të jetë e rezervuar me informacionet. Myslim Murri: PD. Nuk jam dakord që zonja Marku të jetë e rezervuar, por nëse ka informacion të klasifikuar, të rrijë dhe të raportojë ashtu sikur raportohet. Nëse është e cunqur me ne, nuk e di kur raporton Prokuroria e Përgjithshme. Silva Caka: Kemi bërë një kërkesë për anulimin e raportimit, pasi nuk është i përfshirë në draft kalendarin e Kuvendit. Ulsi Manja: Në rregullorë, në pikën 27 të Kuvendit, thuhet raporti vjetor i prokurorit të përgjithshëm. Silva Caka: Është në datë 4 maj. Ulsi Manja: Më liri të bëj detyrën se nuk jemi në kafë këtu. Gent Strazimiri: Kryetari me nënkryetarin dhe sekretarin kanë rënë dakord me orë dhe datat e mbledhjeve, këtë nuk e ka bërë, kjo mbledhje është e paligjshme, klandestine. Ulsi Manja: Rendi i ditës u shpërnda të premtën, të hënën u miratua kalendarin në Kuvend, nuk kam si ta diskutoj në komision kur nënkryetari nuk është. E hedhim në votë propozimin? (Arrihet konsensusi të vijojë mbledhja). Edi Paloka: A ka pasur deputetë apo ministër socialistë që kjo Prokuroria e Krimeve të Rënda i përgjigje për korrupton dhe krimin? Nëse po, çfarë është bërë? Pse kaq e detyrë lidhet me emërimet dhe shkarkimet në kundërshtim flagrant me kompetencat që u njeh ligji? Shkarkuat Hajdarmatajn dhe aty dërguar një shoqen tuaj. Pyetja e fundit lidhet me një çështje mjaft të ndryshme. Atë të Geron Agron, Fatmir Xhafajt dhe njëjten e hetimeve nga Krimet e Rënda me 4 ditë vonë, kur ai është larguar nga Shqipëria. A e keni marrë Ramën ta pyesni për ekspertizën e deklaruar prej tij? Pse se zbatoni ligjin Antimafie për Fatmir Xhafajn? Arta Marku: Sikur konstatohet edhe nga ju, pyetjet nuk kanë lidhje me raportin, unë jam për të prezantuar raportin, megjithatë disa përgjigje do u jap. Sikur jeni në dijeni, me reformën e re prokuroria ka pësuar ndryshime për organizimin, një i centralizuar është bërë i decentralizuar. Përsa i përket emërimeve dhe shkarkimeve, gjatë ushtrimit të funksioneve të mia kam zbatuar ligjin e Kushtetutit dhe dispozitat tranzitore. Kam bërë caktime të përkohshme të prokurorëve, më lejohet dispozita kalimtare, nuk kanë procedurë që duhet ndjekur, janë të përkohshme. Unë kam ndjekur disa kritere. Kam marrë informacione të karakterit sekret. Kush nuk është dakord nga personat e lëvizur mund të anketohet në gjykatë, sikur ka ndodhur. Vendimet e mia janë certifikuar edhe nga KPK. Përsa i përket Agron Xhafajt, nuk kam tagër për të pasur informacion konkret. Asnjë prokuror nuk mund të vijë të japë informacione konkrete, me përjashtim të komisioneve hetimore. Edi Paloka: Nuk mora përgjigjet që prisja. Tagër për të lëvizur prokurorët që merren me hetimet e ministrave këni... Këto nuk i ha njëri. Këni ardhur që të jepni llogari. Ua thash, jeni zgjedhur në mënyrë antikushtetuese. Spartak Braho: Këta bëjnë komente, jo pyetje. S'kanë marrë vesh akoma... Flamur Noka: O Spartak, merre më qetë. Se je dhe me shëndet delikat. Nervozizmi dhe stresi nuk të bëjnë mirë. Ulsi Manja: Raporti tregon punën e mirë dhe sipas këtij raporti, prokurorët meritojnë vetëm falënderime. Në 380 prokurorë keni 180 hetime pro aktive, sa një pushuar dhe sa janë çuar për hetim? Nëse ke një qëndrim për emërimin e magistraturës? Sa persona janë në kërkim për vrasje, adrem e tyre? A është thirrur ministria e Drejtësisë për t'u pyetur për çështjen e Setaj? Ulsi Manja: Zonja prokurorë, rezervohuni me këto adresat e të kërkuarve se po ti dinim, i kapnim? Arta Marku: Për shpenzimet procedurale, operative janë në 335 milionë lekë, pjesë e raportit. Gjykimet në mungesë për vrasje janë 81, janë pezulluar për vrasje 99 procedime. Procedimet kryesisht janë 143 ka një ujë në krahasinim me 2016. Në lidhje me studentët e Magjistraturës, jam në dijeni që disa studentë kanë përfunduar dhe kërkim të emërimit, por për këtë çështje ka një iniciativë ligjore dhe nuk e shoh të jap ndonjë mendim. A ka lidhje me krijimin e KLP? Nuk e shoh të ketë lidhje. Për pyetjen për ministrin e Drejtësisë, a është thirrur në prokurori... Në Prokurorinë e Përgjithshme nuk zhvillohen hetime apo marrje në pyetje, nëse është thirrur në prokurori, të jera nuk e di. Për çështjen e ekstradimitit po ndiqet nga Prokuroria e Durrësit. Në Prokurorinë e Përgjithshme ka nisur një hetim disiplinor për çështjen e ekstradimit, por në pamundësi për dhënie mase këtu bërë hetimin, pas përfundimit të hetimit do i dorëzohet KLP për masat nëse e çmon.

Ulsi Manja: Zoti Naço, mos hajdeni pa përgatitur, se na krijoni probleme. Nasip Naço: 1500 persona janë në kërkim për vrasje nga 1990. Klotilda Bushka: Përsa i përket ligjit të dekriminalizimit... Zyrtari i prokurorisë: Kjoa: Përsa i përket kometit për tendencën në rritje për disa vepra penale, informacionin mund t'ua vendos në një moment të dytë. Në lidhje me dekriminalizimin është bërë një punë e rëndësishme, por duan të evidentoj lidhjet me disa vonesa për këtë proces. Edhe pse afati i vendosur është tremujor, mendoj që nuk i përgjigjet realiteti kur nevojia e verifikimit është për jashtë shtetit. Do të doja që Kuvendi ta rishikonte këtë situatë, por edhe parashikimin për tagrin e prokurorit për marrëveshjen për marrjen e informacionit. Flamur Noka: Nuk është prokurorë e përgjithshme, është funksionare publike. Nuk është thirrur në tagrin e Arta Markut, por në tagrin e drejtuesve dhe nuk mund të thotë "nuk e di, s'kam informacion" etj. Duhet ta fusim në hulli këtë seancë. Kjo është PPP, prokuroria private politike. Duhet të kthejë përgjigje konkrete, jo të bëjë përalla. Ulsi Manja: Nuk kthehet me prokurori që ishte, jemi në proces për të ngritur organet e reja. Flamur Noka: Kjo është zgjedhur me 69 vota, është PPP, prokuroria private politike. Por ajo duhet të japë llogari dhe jo këtë e di dhe këtë se di. Ulsi Manja: Zonja Marku u falënderoi, po është edhe kolegat, përsa kohë deputetët e opozitës vijojnë zhurmën dhe e konsiderojnë sallën e Kuvendit si sallë teatri, jam i detyruar të zbatoj rregullorën... Fjala për ju, zonja kryeprokurore. Edi Paloka: Kjo nuk ka asnjë logjikë, kush jeni ju? Jeni kryetari zbatoni rregullorën, deputetët që folën e kërkuan për procedurë, prokuroria nuk po përgjigjet. Ulsi Manja: Pse doni të përgjigjet sikur doni ju? Edi Paloka: Çështjet që dëgjuam nuk i di, por për çfarë është aty për të marrë rogen? Por nesër do të përgjigjeni një mi. Ulsi Manja: Deputeti bëni pyetje, por nuk mund të imponohet, ju e konsideroni sallën e komisionit "livadh", o kthyer e mi, këtu nuk është livadh". Flamur Noka: Livadh e keni kthyer ju. Myslim Murri: Kjo po raporton për Liallën, por më pas kanë ndodhur ngjarje shumë të rëndësishme. Pse nuk është konstituuar KLP, pse nuk zgjidhet trupa që është në dorën tuaj. Deklaruat se dërguat për hetim 17 banda, këto janë pjesë e ansambllit të 40 bandave që thotë Xhafaj. Ministri deklaroi se janë, dhe u vendos fejn ju, pasi nuk i kapni. Në ditë u habita, 176 procedime, 79 të dënuar, këta janë ishatarë, shoferë, roje apo ato që e mbjelin. Këni bërë 145 arrestime. Arta Marku: Për pyetjen se përse ka ngecur KLP, do të kisha dëshirë t'ju jepja një përgjigje, por nuk është në kompetencat e mia, të gjithë ata që kanë kandiduar janë në vetting. Kanë kandiduar 17, po ti rri, ti kujtoj me emra. Pasi kalonin, lista dorëzohet te Prokurori i Përgjithshëm, më pas mbi bazën e një rregullatore veprohët. Kur prokurorët promovohen, kontrollohen cilësitë. Më pyetët për disa funksionare të dënuar për korrupton se cilës parti i përkasin, por një zë i tillë nuk parashikohet në statistikat dhe këtë përgjigje nuk u jap dot. Më pyetët për disa banda, bëhet fjalë ata të dënuar në 2017-ën, ministri i Brendshëm flet për banda që janë evidentuar në 2018, në ditërinë time, nuk mund të jap... Unë i jap përgjigjet sikur i mendoj. Nuk mund të them kush janë bandat e dënuara apo... Edhe për ata që janë dënuar për kanabis nuk ka një zë se çfarë përfaqësojnë. Më pyetët për disa konfiskime, hetimi pasuror nuk ka qenë në nivele të admirueshme, ky sektor ka probleme, në jemi duhe përgatitur një udhëzim siçs duhet të veprojnë. Ka shumë probleme. Klevvis Balliu: Kjo është "Zonja nuk e di". Me ardhmë këtu të presim prokurorin, na sollët këtu "Zonjen nuk e di". Kjo nuk di asgjë! Kjo nuk ka faj që nuk di asgjë, sepse nëse doni prokurorinë, duhet të vijë Edi Rama këtu, sepse ai është kryeprokuror. Ajo zonja me të vërtetë nuk di asgjë. Kjo erdhi dhe rezultoi zonja "Nuk e di". Jemi prokurorin Kosta Beluri në Prokurorinë e Përgjithshme, që i pushoi çështjen e Admir Hanzes, me çfarë kritereës merreni ju? Kjo është një zëvendësim e "mala vitës". Ulsi Manja: Iu tërheq vëmendjen, respektoni kodin e etikës, nëse je mësuar te komisioni yt... Klevvis Balliu: Nuk më ndërpret dot... pse e nxorët Tahirin nga arresti i shtëpisë, pse i futët kukullat në burg, kush ua dha këtë urdhër? Ulsi Manja: Iu tërheq vëmendjen, në këto kushte të ndonjë kolegë e ndëruar zonja prokurorë, nuk kanë hallin e raportimit dhe nivelin e kriminalitetit se këta e kanë pasur modë të kenë Prokurorinë e Përgjithshëm. Më këto shkelje flagrante të Kodit të Etikës së deputetit Balliu e nbyllim mbledhjen e komisionit.

PAKTI SHQIPËRI-GREQI REAGIMET

Deklarata e komisionerit të BE shqetëson mediat greke: Frikë për spastrim etnik

Befason komisioneri Hahn: Ristrukturim kufijsh midis Greqisë dhe Shqipërisë

Pakti detar, Bushati-Kotzias takohen në Bruksel

Komisioneri i BE për Zgjerimin, Johannes Hahn, ka bërë një deklaratë në një konferencë për shtyp nga Londra, e cila është diskutuar gjatë në mediat greke. Hahn ka thënë se Shqipëria dhe Greqia po shkojnë drejt një marrëveshjeje për rindërtimin e kufijve. "Unë mendoj se ne kemi parë vendime prej burrash shteti si për shembull për negociatat rreth çështjes së emrit. Me të gjitha gjasat do të kemi një marrëveshje mes Shqipërisë dhe Greqisë, sepse ajo e cila po diskutohet lidhet me një rindërtim të kufijve dhe e gjitha kjo është gjithmonë e rëndësishme dhe kritike për qytetarët", deklaroi Johannes Hahn. Pas deklaratave të Hahn, ende nuk ka ardhur një reagim zyrtar nga ana e qeverisë greke. Ndërsa mediat greke si "Cathimerini" dhe "Proto Thema" shkruajnë se janë tejet të shqetësuar për mënyrën se si Nikos Kotzias i Greqisë po i trajton negociatat me Shqipërinë në konkretisht çështjen e minoritetit etnik grek në jug të Shqipërisë. Ato shkruajnë se kanë frikë se "spastrimi etnik", të cilit i janë nënshtruar qytetarët nga qeveritë shqiptare, do të vazhdojë. Pas bujës së bërë në mediat greke të deklaratës së Hahn, një reagim ka ardhur edhe nga një zëdhënës i Komisionerit, i cili është shprehur se ai nuk i referohet ndryshimit të kufijve. "Në asnjë mënyrë komisioneri Hahn nuk i referohet një ndryshimi kufitar. Ai u referohet bisedimeve të vazhdueshme greko-shqiptare mbi zonën ekskluzive ekonomike, e cila mund të arrihet vetëm në bazë të një marrëveshjeje të pranueshme reciproke mes dy vendeve", u shpreh zëdhënësi. Komisioneri foli në konferencën me temë "Përtej Berlinit. Çfarë presim dekadën e ardhshme për Ballkanin Perëndimor", organizuar nga Instituti Mbretëror i Çështjeve Ndërkombëtare, ose siç njihet gjerësisht, 'Catham House'. Nga ana tjetër, një ditë pas takimit të Edi



Komisioneri i BE për Zgjerimin, Johannes Hahn

Ramës me kryeministrin grek, Aleksis Tsipras në Londër, dhe kanë zhvilluar një tjetër takim ministrit e Jashtëm, Ditmir Bushati dhe Nikos Kotzias. Bushati dhe Kot-

zias janë takuar gjatë punimeve të Samitit të NATO-s në Bruksel. Në fokus të bisedës kanë qenë marrëveshjet mes dy vendeve, të cilat janë drejt finalizimit. Dy ministrit janë

njohur me arritjet e deritashme nga ekipet negociatore si dhe kanë cilësuar prioritet për të dyja vendet, ecurinë e dialogut me qëllim finalizimin e marrëveshjeve.

TAKIMI BUSHATI-KOTZIAS

Një ditë pas takimit të Edi Ramës me kryeministrin grek, Aleksis Tsipras në Londër, sot kanë zhvilluar një tjetër takim ministrit e Jashtëm, Ditmir Bushati dhe Nikos Kotzias, në Bruksel. Në fokus të bisedës kanë qenë marrëveshjet mes dy vendeve, të cilat janë drejt finalizimit.




Dje në samitin e NATO-s

KREU I PR NË BUNDESTAG

Mediu: Shqipëria, rast unik në Europë pa Gjykatë Kushtetuese

Kryetari i Partisë Republikane, Fatmir Mediu ishte i pranishëm gjatë punimeve të Asamblesë Parlamentare të OSBE, e cila u mbajt në Parlamentin gjerman. Ai ngriti problemin e mungesës së Gjykatës Kushtetuese dhe bllokimin e Gjykatës së Lartë. Gjatë flajës së mbajtur në seancën plenare, në emër të opozitës Mediu vlerësoi se në qendër të punës së OSBE është mbrojtja dhe garantimi i të drejtave të qytetarëve, e drejta e tyre për të vendosur nëpërmjet votës, zgjedhjeve të lira dhe të ndershme. Ai theksoi se nëse OSBE vëzhgon zgjedhjet dhe bën r e k o m a n d i m e, atëherë është e domosdoshme që ajo të ndjekë zbatimin e tyre, e në mënyrë të veçantë, blerjen e votës, influencën e kriminit të organizuar në zgjedhjet dhe kapjen e shtetit, të cilat ai i cilësoi si rrezikun më të madh, veçanërisht në Shqipëri. Në këtë kontekst ai u shpreh se garantimin e të drejtave të qytetarëve e siguron një gjyqësor i pavarur. Mediu e cilësoi Shqipërinë si një rast unik në Europë që nuk ka Gjykatë Kushtetuese apo me një Gjykatë të Lartë të bllokuar, duke përmendur si shembull Amerikën, vend në të cilin zhvillohet debat se kush duhet të jetë anëtar i Gjykatës së Lartë, një kohë kur në Shqipëri kjo gjykatë nuk funksionon fare.



Ministri: Ti trajtomë si pjesë e bashkësisë shqiptare

Majko, projektligj për përfshirjen e diasporës në qeverisjen vendore

Përfshirja e diasporës në strukturën e qeverisjes vendore është synimi i projektligjit të propozuar nga ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko, "Disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.139/2015 'Për vetëqeverisjen vendore'". Drafti u diskutua në mbledhjen e radhës së Këshillit Konsultativ, Qeveri Qendrore-Vetëqeverisje Lokale. Ndërsa përmendi ligjet e miratuar në kohë rekord për diasporën, ministri Majko tha në fjalën e tij se struktura e re ligjore parashtron nevojën për ndryshime. Në ligjin "Për vetëqeverisjen vendore", sipas ministrit duhet të bëhen ndryshime dhe shtesa që do të garantojnë trajtimin e shqiptarëve jashtë vendit si pjesë integrale të bashkësisë sh-



qiptare. Ndër të tjera, z. Majko propozon krijimin e zyrave të posaçme për diasporën nëpër bashkitë e vendit, të cilat do të shërbe-

jnë si pika komunikimi të përfaqësuesve të komunitetit jashtë vendit me pushtetin lokal. Ato do të ofrojnë informacione dhe ndihmë për çështjet të ndryshme lidhur me dokumentacionin, biznesin etj. Ministri shtoi se problemet e regjistrimit apo të pashtetësisë duhet të adresohen edhe në nivel lokal dhe prandaj krijimi i një zyre të tillë është i rëndësishëm. Zyra do të shërbejë si një urë lidhëse edhe për ata shtetas jashtë vendit, që janë të interesuar për investime.

Përmbareuesi Gjyqësor Privat Z. Medar Kajolli, njofton shpalljen për shitje në ankand të parë për pasuritë e paluajtshme si më poshtë:

- Pasuria Nr. 250/3+1-2, Vol.-31, fq.-234, Z.k-1791, Apartament me Sip.-209.7 m², ndodhur në Golem, Kavajë, me vlerë 7'549'200 Lekë.
- Pasuria Nr. 250/3+1-3, Vol.-31, fq.-235, Z.k-1791, Apartament me Sip.-209.7 m², ndodhur në Golem, Kavajë, me vlerë 7'549'200 Lekë.
- Pasuria Nr.211/11, Vol.-4, fq.-201, Z.k-1791, Iloj Tokë-0Arë me Sip.-500 m², ndodhur në Golem Kavajë, me vlerë 400'000 Lekë.

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 12.07.2018, në orën 16.00, në ambientet e zyrës së Përmbareusit Gjyqësor Privat Z. Medar Kajolli, me adresë: Rruga "Urani Pano", Pll.-/13, Kati -2, Tiranë. Col. 069 73 23 003, email: medar.kajolli@yahoo.com

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Përmbareuese "E.G Bailiff Service" me përmbareues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Ruvoa, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se me date 07.08.2018 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i II për shitjen e pasurisë të paluajtshme Truali me sipërfaqe totale 500 m² nga e cila Ndëtesë me sipërfaqe 128 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Durrës me Nr pasurie 72/67, Vol.3, Fq.183, Zk.1242 në pronësi të Z.Sali Ibrahim Jamaku me vlerë fillestare në ankand 90,048 (Nentëdhjetë mijë e dyzet e tete) EURO . Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com



Kryeministri në Samitin e NATO-s: Shqipëria u vlerësua pozitivisht

"Defi", Rama: Problemet të vështira, por të arrijmë nivel të ri bashkëpunimi

"Marrëdhëniet me Greqinë duhet të kapërcejnë të kaluarën"

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama u shpreh dje, nga Samiti i NATO-s në Bruksel se Shqipëria ka marrë vlerësime pozitive për angazhimin e saj në Aleancë, për rritjen e buxhetit ushtarak, pjesëmarrjen në misione si dhe përpjekjet në luftën kundër terrorizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Kryeministri Edi Rama ka komentuar përmes një postimi në rrjetet sociale punimet e Samitit të NATO-s, teksa ka shpërndarë edhe një video nga takimi me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, punimet e Samitit e deri te fotoja zyrtare e liderëve të shteteve anëtare, përkrah Donald Trump dhe Angela Merkel. "Shqipëria vlerësohet shumë pozitivisht për kontributin e saj në programin e Aleancës; rritjen e buxhetit të mbrojtjes; pjesëmarrjen me 13% të trupave të veta në frontet e përbashkëta; qasjen aktive kundër terrorizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Duke vlerësuar lart marrëveshjen e arritur mes Athinës e Shkupit, Shqipëria mbështet nisjen e procedurave për anëtarësimin sa më parë në NATO të Republikës së Maqedonisë së Veriut", tha dje, Rama.

Ndërkohë më herët, gjatë një interviste për agjencinë greke të lajmeve "AMNA", kryeministri shqiptar Rama



Kryeministri Edi Rama me sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg

DEKLARATA
"Gjëja më e rëndësishme është që jo vetëm t'i zgjidhim këto probleme, por t'i çojmë ato në një tjetër nivel bashkëpunimi dhe partneriteti. Marrëdhëniet mes dy vendeve duhet të kapërcejnë të kaluarën dhe të arrijnë në nivelin e marrëdhënieve që kanë qytetarët e dy vendeve mes njëri-tjetrit", - u shpreh kryeministri Rama.

RISHFAQET VISHO AJAZI

Kryeministri Edi Rama, në vizitën e tij në samitin e NATO-s është shoqëruar nga delegacioni shqiptar, i përbërë nga ministrit Bushati e Xhaçka, por jo vetëm. Në krah të kryeministrit është fotografuar edhe ish-kreu i SHISH, Visho Ajazi. Pas emërimit të tij si ambasador i Shqipërisë në NATO, Ajazi shënon kështu daljen e tij të parë publike përkrah Ramës.

tha se Greqia dhe Shqipëria do të bien dakord me një dokument të ri bashkëpunimi strategjik. "Problemet janë të vështira mes dy vendeve, por zgjidhja e tyre është absolutisht e nevojshme. Gjëja më e rëndësishme është që jo vetëm t'i zgjidhim këto probleme, por t'i çojmë ato në një tjetër nivel, bashkëpunimi dhe partneriteti. Marrëdhëniet mes dy vendeve duhet të kapërcejnë të kaluarën dhe të arrijnë në nivelin e marrëdhënieve që kanë qytetarët e dy vendeve mes njëri-

tjetrit", u shpreh kryeministri Rama. Kryeministri i Shqipërisë nuk e ka fshehur kënaqësinë e tij me marrëveshjen e Prespës midis Greqisë dhe Maqedonisë. Gjithashtu, Rama vlerësoi edhe samitin e Londrës për Ballkanin Perëndimor, që u mbajt të martën. "Ky është një proces i rëndësishëm që filloi pesë vjet më parë dhe vazhdon, unë mendoj se jemi në ritëm të mirë. Ajo na ndihmon për të namabajtur së bashku dhe të na bëjnë të lëvizim së bashku. Sigurisht, kjo

ndodh një kohë kur gjërat në Evropë nuk janë aq të mirë, kështu që duket si një mallkim ballkanik. Kur Evropa po shkonte mirë, ne kishim probleme, tani po përmirësohemi ne dhe Evropa po përqëqësohet", u shpreh Rama. Kryeministri Edi Rama dhe homologu i tij grek, Aleksis Cipras u takuan të martën në Londër, në kuadër të Samitit të Ballkanit Perëndimor. Dy kryeministrit diskutuan rreth negociatave mbi një numër të madh çështjesh, që po drejtohen nga ministrit e Jashtëm dhe vlerësuan arritjet e deritanishme. Çështjet për të cilat është rënë dakordësi nga ekipet negociatore mes dy vendeve janë ato për detin, shfuqizimi i ligjit të luftës, heqja e sekuestros për pronat e shqiptarëve në Greqi, apo dhe mospërdorimi i mëtëjshëm i emrave Vorio-Epir dhe Çamëri.

Berisha: Të ngrihemi e të flakim Ramën dhe klikën e tij tradhtarë

Ish-kryeministri Sali Berisha reagoi dje, pas deklaratës së Komisionerit Johannes Hahn për marrëveshjen mes Shqipërisë dhe Greqisë. Në një status, në 'Facebook', Berisha shkroi: "Komisioneri Hahn heq petët e lakrorit të tradhtisë kombëtare të Jorgo Zografit të dytë! Në Chatham House ai flet për ristrukturim kufijsh midis Shqipërisë dhe Greqisë! Kjo deklaratë e një personaliteti të lartë politik të Brukselit dëshmon edhe një herë se Jorgo Zografi i dytë me Ditziun e tij kanë vendosur copëtimin e ri, i dyti që nga viti 2013 të trojeve shqiptare, për të ruajtur me çdo çmim karrigen dhe pushtetin e tyre të bazuar në një akt tradhtie të lartë kombëtare të pashembullt në historinë e shtetit shqiptar. Sot më shumë se kurrë unë u bëj thirrje shqiptarëve të ngrihemi dhe të flakim me urgjencë nga pushteti Jorgo Zografin e dytë dhe klikën e tij tradhtarë!", shkroi Berisha.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi catering në ambientet e Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 10.200.000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halli", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi catering në ambientet e Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 02 Gusht 2018, ora 10:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

PROCEDURE PROKURIMI

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Përzgjedhja e agjencisë së udhëtimit për pajisjen e stafit të Bankës së Shqipërisë me bileta udhëtimi"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Procedurë e veçantë sipas vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 65, datë 26.11.2014, i ndryshuar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 17.500.000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halli", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Përzgjedhja e agjencisë së udhëtimit për pajisjen e stafit të Bankës së Shqipërisë me bileta udhëtimi"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 03 Gusht 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Taksat mjedisore rriten në 3.24% të PBB

Taksat e transportit mbledhin më shumë të ardhura

Të ardhurat në buxhetin e shtetit nga taksat mjedisore u rritën me 8.64% gjatë vitit 2016, duke kapur vlerën e gati 48 miliardë lekëve. Tashmë pesha e taksave që lidhen me energjinë, transportin dhe ndotjen është ngjitur në 3.24% të Prodhimit të Brendshëm Bruto, krahasuar me 3.07% në vitin 2015, sipas të dhënave të fundit të INSTAT. Rritja është shoqëruar në të ardhurat nga të gjitha llojet e taksave mjedisore, ku dominojnë taksat e energjisë dhe të transportit. Taksat e energjisë, të cilat përfshijnë ato të karburan-

tit të makinave, ato mbi prodhimet e energjisë në vend dhe format e tjera të energjisë, arritën në 24.5 miliardë lekë, nga 22.9 miliardë lekë një vit më parë. Megjithatë, peshën më të shtuar raporton SCAN e kanë taksat e transportit, të cilat i referohen taksave të lidhura me pronësinë dhe përdorimin e automjeteve, por edhe mjeteve të tjera të

transportit. Nga ky grup u arkëtuan rreth 21.3 miliardë lekë, krahasuar me vetëm 19.2 miliardë lekë një vit më parë. Ndër të gjitha llojet e taksave mjedisore, ato të transportit kanë parë edhe rritjen më të madhe gjatë pesë viteve të fundit, duke u dyfishuar që prej vitit 2012. Në rritje të lehtë janë edhe të ardhurat nga taksat e ndotjes

mbi emetimet në ajër (jo CO2) dhe shkarkimet në ujë, menaxhimet e mbetjeve dhe zhurmës. Ato arkëtuan 1.88 miliardë lekë, një vlerë më e ulët krahasuar me vitin 2014, megjithatë e ngjashme për të gjitha vitet. Ndërkohë, nga taksat e burimeve natyrore (shfrytëzimi i ujit, pyjeve, kafshëve të egra, etj.) u arkëtuan vetëm 16 milionë lekë, në ujë



me 3 mln krahasuar me një vit më parë. Në total, të ardhurat nga taksat mjedisore shërbejnë për të kontrolluar ndotjen

dhe menaxhuar burimet natyrore. Ato ndikojnë në sjelljen e bizneseve, prodhuesve dhe konsumatorëve.

Tregjet nën mbikëqyrje, rritet numri i ankesave që qytetarët dorëzojnë për zgjidhje

Dëmet në aksidente, AMF: Denonconi në rast të mospagesës

Miratohet fondi i kompensimit për vitin 2018, 1.8 miliardë lekë

Ornela Manjani

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare vë theksin tek rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për të kërkuar të drejtën e tyre duke shfrytëzuar mekanizmat që institucioni ka vënë në dispozicion. Autoriteti u kërkoi qytetarëve të denoncojnë rastet kur nuk marrin pagesën e dëmit sipas ligjit në fuqi. Një prej tyre ka të bëjë me paraqitjen e ankesave drejtpërdrejt në AMF. Sipas autoritetit deri në datën 27.06.2018 janë depozituar 41 ankesa për çështje të ndryshme, mbi 90% e tyre të lidhura me tregun e sigurimeve. "Ankesat kanë të bëjnë kryesisht me refuzimin e pagesës së dëmshpërblimit, mosrënien dakord për vlerën e dëmshpërblimit apo pretendime për vonesë në trajtimin e praktikave nga ana e shoqërive të sigurimit.

ANKESAT
Autoriteti ka trajtuar brenda afateve kohore të gjitha ankesat e konsumatorëve dhe po vijon me adresimin e tyre. Nga 41 ankesat e paraqitura, thuajse gjysmës i është dhënë zgjidhje përfundimtare në favor të konsumatorit dhe rreth 20% janë në proces trajtimi, të depozituara të gjitha në muajin qershor, brenda afateve. Për pjesën tjetër të ankesave të paraqitura në Autoritet, është mbyllur trajtimi dhe iu është dhënë informacioni i nevojshëm. Nga shqyrtimi i çështjeve të ankimura, rezultoi se mosmarrëveshjet e lindura mes konsumatorit dhe shoqërive



Foto ilustruese

të sigurimit kanë ardhur si pasojë e mosinformimit të plotë në lidhje me kontratën e sigurimit. AMF këshillon konsumatorët të njihen me kujdes me kushtet e kontratës përpara nënshkrimit të saj dhe të kërkojnë sqarime nga shoqëritë derisa të kuptojnë plotësisht dokumentin që po nënshkruajnë dhe përfitimet prej tij. Synimi i Autoritetit është ruajtja e një komunikimi të hapur e të drejtpërdrejtë me konsumatorët për të marrë asistencën e nevojshme për hapat që duhen ndjekur në lidhje me ankesat për të gjetur zgjidhje të problematikave të tyre.

ADRESAT PËR DENONCIM

Qytetarët për çdo problematikë ose ankesë janë të lutur të kontaktojnë me Autoritetin përmes adresës së posaçme të e-mailit, që gjendet në faqen zyrtare të AMF,

konsumatori@amf.gov.al, si dhe numrit të telefonit +355 4 22 57 560. Gjithashtu, nga viti i kaluar është funksionale faqja zyrtare e Autoritetit në Facebook, nëpërmjet të cilës qytetarët kanë marrë përgjigje për pyetje apo shqetësime të ndryshme të ngritura prej tyre" njofton AMF.

DËMET

Problematika e mbartur nga viti 2001, me pagesat e prapambetura me Fondin e Kompensimit duket se po shkojnë drejt zgjidhjes. Vendimi i marrë mbi Fondin e Kompensimit për vitin 2018 nga Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, në mbledhjen e datës 28 dhjetor 2017, vjen në funksion të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve, çka i jep zgjidhje një problematike të mbartur nga viti 2001. Tashmë këto dëme i përkasin aksidenteve të shkaktuara

nga makina të pasiguruara ose të paidentifikuara. Sipas vlerësimeve masa e Fondit të Kompensimit për detyrimet e mbartura dhe që do të lindin për vitin 2018 vlerësohet rreth 1.8 miliardë lekë, ndarë: 1.25 miliardë lekë për ngjarjet nga viti 2001 deri 31.12.2013 ku përfshihen detyrime të papaguara, që janë në proces trajtimi apo proces gjyqësor pa vendim të formës së prerë; 418 milionë lekë për ngjarjet nga viti 2014 deri në 31.12.2017 ku përfshihen detyrime të papaguara, që janë në proces trajtimi apo proces gjyqësor pa vendim të formës së prerë, dhe jo më pak se 150 milionë lekë për ngjarjet që mund të ndodhin gjatë vitit 2018.



Nyja e Milotit, nisin punimet

Gjikhuri: Investim 1.6 mld lekë, përfundon për 15 muaj

Rreth 1.6 mld lekë do të jetë investimi i qeverisë shqiptare për përfundimin e punimeve në nyjën e Milotit, e cila është konsideruar një pikë strategjike për trafikun pasi lidh Rrugën e Kombit me aksin që shkon nga Tirana drejt Shkodrës. Teksa inspektoi nisjen e punimeve, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjikhuri tha se prej muajit gusht nyja do të bëhet funksionale, duke synuar lehtësimin e trafikut të mjeteve gjatë sezonit turistik. "Edhe gjatë kësaj vere, gjithë pushuesit do ta ndjejnë diferencën e madhe që do të ketë lehtësimi i trafikut pikërisht në këtë nyje. Kjo është një nga ato veprat e tjera të rëndësishme që ne jemi duke hapur. Këtu do të jetë edhe lidhja me autostradën nga Miloti deri në Ballëdren", u shpreh Gjikhuri. Kreu i Autoritetit Rrugor Shqiptar, Afrim Qëndro bëri me dije se punimet pritet të përfundojnë tërësisht brenda 15 muajve. "Jemi në nyjen e Milotit. Ka pak ditë që është lidhur kontrata për përfundimin e punimeve të ngelura dhe plotësimin me rrugë dytësore për gjithë nyjen e Milotit. Është një vepër që ka shumë vite që ka filluar, kishin ngelur punimet të pabëra. Kjo nyje nuk mund të futej në shfrytëzim nëse nuk bëhej ky projekt i ri dhe kjo garë e re. E kemi nisur punën dhe përfundimisht brenda 15 muajve kjo nyje do të përfundojë me të gjitha zgjidhjet e plota teknike", tha Qëndro. Përveç nyjes, ndërhyrja parashikon edhe rehabilitimin e 9 kilometra rrugë në gjithë zonën që është përreth saj.

Qeveria merr hua nga BERZH për rrugët rajonale dhe lokale

Fond 50 milionë USD kredi

Qeveria shqiptare pritet të marrë një hua prej 50 milionë dollarësh, e cila do të shpenzohet për projektin e konjektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale. Marrëveshja që do të lidhet me Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim nga mbërritur për diskutim në Kuvend, ndërsa parashikohet që shlyerja e huasë të bëhet për një periudhë prej 29.5 vite. Referuar relacionit të projektligjit, efektet e pritshme nga zbatimi i këtij projekti lidhen me rehabilitimin e rrugëve rajonale dhe lokale, duke ofruar një lidhje më të mirë dhe më të sigurt me rajonet e



përfshira ku jetojnë e punojnë rreth 80 000 banorë. Po ashtu, pritet përmirësimi i klimës së qëndrueshmërisë në rrjetin rrugor, çka do të ndihmojë në përfundimin e një aftësie të qëndrueshme dhe të dëshiruara në sigurimin e shërbimeve të transportit. Një pjesë e huasë do të shkojë edhe për ngritjen

e kapaciteteve të bashkive për të menaxhuar dhe mirëmbajtur rrjetet rrugore. Po ashtu, parashikohet mbështetja e bashkive të përzgjedhura për implementimin e programeve të zhvillimit rural, përfshirë dhënie dhe këshillave për vlerësimin e potencialit të tregut në nivel fshati për të përcaktuar se cilat aktivitete prodhuese japin kthimin më të lartë, përgatitjen e propozimeve për investime për të përdorur fondet e grantit të disponueshme në programin "100 fshatrat" ose në programet e tjera të zhvillimit rural për të adresuar kërkesat e tregut dhe zbatimin e aktiviteteve të lartpërmendura.

Tatimet publikojnë listën e "zezë" të bizneseve që nuk lëshojnë kupon tatimor

Ornela Manjani

Kontrollet e turizmit, 30.4 milionë lekë gjoba për 869 subjekte me shkelje

Për 22 qershor-8 korrik janë kontrolluar 1,772 subjekte tregtare

Drejtorja e Hetimit Tatimor njofton se po ushtron kontrolle të vazhdueshme në sektorin e turizmit, me fokus të veçantë zonat bregdetare, me qëllim parandalimin dhe goditjen e informalitetit, si dhe sigurimin e mbarëvajtjes së sezonit. Për periudhën 22 qershor - 8 korrik janë kontrolluar në total 1,772 subjekte tregtare. Nga këto, 49% e subjekteve (ose 869) kanë rezultuar me shkelje, që kanë kapur vlerën e rreth 30.4 milionë lekëve. Numri më i lartë i penaliteteve është vendosur për moslëshim të kuponit tatimor dhe këto raste zënë rreth 22% ndaj totalit. Për tri subjekte që nuk kishin lëshuar kupon tatimor për herë të dytë u mor masa e mbylljes së veprimtarisë ekonomike për 30 ditë kalendarike, sipas legjislacionit në fuqi. Gjithashtu, nga kontrollet e Drejtorisë së Hetimit Tatimor rezultoi se 54 subjekte ishin të paregjistruara në organin tatimor. Ndërsa u konstatuan 140 tatimpagues që dispononin mallra të pashoqëruara me dokumentacion tatimor. Për punonjës të padeklaruar në organin tatimor, strukturat e specializuara të kësaj drejtorie penalizuan 144 subjekte. Drejtorja e Hetimit Tatimor në DPT tërheq vëmendjen e tatimpaguesve që operojnë në zonat turistike të respektojnë detyrimet ligjore: për dokumentimin e mallrave gjendje apo në transport, për të lëshuar kupon tatimor/faturë tatimore për çdo transaksion që tatimpaguesi kryen me klientët e tij, për të regjistruar të gjithë punonjësit e angazhuar në biznes me kohë të plotë apo të pjesshme, si dhe për të afishuar çmimet e shitjes së mallrave apo të shërbimeve të ofruara. Në kuadër të planit të masave për sezonin turistik, këto struktura do të verifikojnë më shumë se 16,000 tatimpagues në të gjithë vendin - përfundon njoftimi i tatimeve.

LISTA E ZEZË
Administrata tatimore ka nisur publikimin e një liste me emrat e bizneseve që nuk lëshojnë kuponin tatimor. Lista përmban vetëm 127 subjekte, të cilat siç shihet nga uebi i tatimeve janë subjekte të gjetura me shkelje të përdorimit të kasës fiskale me shumë se një herë. Kundërvajtës cilësorë subjektet që nuk instalojnë pajisjen fiskale ose sisteme të monitorimit të qarkullimit. Gjithashtu, "Tatimet" kanë vendosur të publikojnë identitetin e biznesit nëse pas verifikimit të parë, konstatohet se tatimpaguesi vazhdon të mos e instalojë pajisjen fiskale dhe situata nuk është rregulluar brenda 15 ditëve. Tatimet sqarojnë se do të pub-



Foto ilustruese


MASAT
Numri më i lartë i penaliteteve është vendosur për moslëshim të kuponit tatimor dhe këto raste zënë rreth 22% ndaj totalit. Për tri subjekte që nuk kishin lëshuar kupon tatimor për herë të dytë u mor masa e mbylljes së veprimtarisë ekonomike për 30 ditë kalendarike, sipas legjislacionit në fuqi. Gjithashtu, nga kontrollet e Drejtorisë së Hetimit Tatimor rezultoi se 54 subjekte ishin të paregjistruara në organin tatimor.

likohet identiteti i çdo subjekti që nuk lëshon kupon tatimor për të dokumentuar qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve për çdo konstatim të përsëritur të moslëshimit të kuponit tatimor, pas dy konstatimeve të para. Kuponi

tatimor i lëshuar nga pajisja fiskale është dokumenti tatimor i kërkuar ligjërisht për çdo tatimpagues, që shtet mallra apo ofron shërbime para në dorë. Në mbështetje të këtij detyrimi ligjor, pranë administratës tatimorë është ngritur një

sistem monitorimi online, i cili ndjek dhe regjistron çdo ditë, të dhënat e transmetuara nga pajisjet fiskale të çdo tatimpaguesi. Tatimpaguesit e shitjeve me pakicë, që shesin mallra apo ofrojnë shërbime në mjedise apo njësi të përhershme, të hapura

për publikun, janë të detyruar të instalojnë pajisje fiskale dhe të lëshojnë kuponë tatimorë për çdo transaksion. Tatimpaguesi dënohet me gjobë në rast se nuk lëshon kupon tatimor në konstatimin e parë të kryer dhe përveç masës së gjobës, për tatimpaguesit e regjistruar për TVSH-në bëhet vlerësim tatimor për tre muajt e fundit, duke përdorur metodat alternative. Në konstatimin (verifikimin) tjetër pas konstatimit të parë, nëse tatimpaguesi vazhdon të mos e lëshojë kuponin tatimor, përveç aplikimit të gjobës si në nënndarjen "a", merret masa e bllokimit të veprimtarisë për 30 ditë kalendarike. Çdo konstatim i përsëritur i moslëshimit të kuponit tatimor, pas dy konstatimeve të sipërpërmendura, përveç aplikimit të dënimit si më lart, konsiderohet evazion tatimor. Tatimet kanë vendosur të publikojnë listën e kundrajvatësve të kuponit të tatimor për të rritur vullnetarizimin e bizneseve në lëshimin e tij, në këmbim të mosprishjes së imazhit.



Klossi, letër bizneseve: Merrni masa për sigurinë në plazhe

Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klossi, u ka dërguar një letër kryetarëve të bashkive bregdetare, të cilëve u kërkon të marrin masa për sigurinë në plazhe gjatë sezonit turistik. Në letërën e tij, Klossi u kërkoj kryebashkiakëve të ndërpresin kontratat me privatët që nuk zbatojnë ligjin për sigurinë në plazhe. "Keni përgjegjësinë për zbatimin rigoroz të ligjit për sigurinë në det", u ka kujtuar Klossi kryebashkiakëve të vijës bregdetare nga Shkodra në Sarandë dhe Bashkisë së Pogradecit.

Krijohet Agjencia Kombëtare e Ujësjellës - Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve

Këshilli i Ministrave ka miratuar ditën e sotme vendimin për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve. Zbatimi i politikës specifike shtetërore në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, trajtimi i ujërave të ndotura dhe planifikimi territorial dhe infrastruktura e mbetjeve është edhe misioni kryesor i kësaj agjencie. Referuar vendimit, drejtori i përgjithshëm i këtij institucioni do të emërohet nga ministri përgjegjës për çështjet e infrastrukturës, ndërsa struktura dhe organika e AKUM-së miratohen me urdhër të kryeministrit. AKUM do të ushtrojë një sërë kompetencash, që përfshijnë propozime mbi ndryshimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor e nënligjor në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, të trajtimit të



ujërave të ndotura, planifikimit territorial dhe infrastrukturës së mbetjeve, përgatitje të planifikimit e nevojave për investime për ndërtimin/rehabilitimin/zgjerimin e sistemeve të përmendura më sipër, përgatitje për metodologjinë dhe kryen shpërndarjen e subvencioneve të planifikuara në buxhetin e shtetit për këto sektorë dhe do të ushtrojë

kontrolle teknike në çdo subjekt dhe ofruar të këtyre shërbimeve në sektorët që përfshijn kjo agjenci, etj. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi pas botimit në Fletoren Zyrtare, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve (AKUK) rristruket në Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve.



Vendimi i Këshillit të Ministrave, jepet me koncesion aeroporti i Kukësit

Këshilli i Ministrave ka miratuar bonusin për dhënie me koncesion të aeroportit të Kukësit. Lidhur me këtë vendim është ngarkuar Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e tij. Në 1 prill 2016 qeveria arriti marrëveshjen me kompaninë koncesionare që menaxhon Aeroportin e Rinasit, duke i hequr asaj ekskluzivitetin për të gjitha fluturimet, në të gjithë Shqipërinë. Arritja e kësaj marrëveshjeje i hap rrugën përdorimit të Aeroportit të Kukësit për fluturime ndërkombëtare dhe në këmbim kompania gjermane përfiton zgjatjen e kontratës me 2 vjet. Hapja e tregut të fluturimeve pritet të sjellë bileta më të lira. "Miratimi i bonusit prej 8% (tetë për qind) të pikëve i jepet bashkimit të shoqërive "Kastrati", h.a. e "T.M.D Systems LTD", për rezultatin teknik dhe financiar të propozimit të pakërkuar, të paraqitur për procedurën për dhënie me koncesion/Partneritet Publik Privat për projektin e rehabilitimit, të operimit, transferimit të Aeroportit të Kukësit", - thuhet në vendim.

Hetoheshin prej 6 muajsh, sot masa e sigurisë për Haki Dylin e Denis Qanën

DURRËS

Përgjimet telefonike kanë nxjerrë zbuluar efektivin e policisë Haki Dyli, me detyrë trupë shërbimi në Gjykatën e Durrësit. 60-vjeçari së bashku me avokatin Denis Qana u arrestuan dy ditë më parë nga SHÇBA, pasi u premtorin qytetarëve zgjidhjen e çështjeve gjyqësore kundrejt shumës 2000 euro. Polici u zbulua pas fotografimeve dhe përgjimeve sekrete. Mësohet se telefonatat e përgjuara prej muajit shkurt e deri në qershor të këtij viti me persona të ndryshëm kanë qenë provat e pakundërshtueshme që kanë gozhuar punonjësien e policisë, Haki Dyli. Në përgjimet e kryera janë transkriptuar thirrje telefonike që Dyli ka kryer me disa persona, një pjesë e të cilëve ishin emigrantë në Itali. Sipas hetuesve të çështjes, Dyli prezantohet si ndërmjetës dhe u premtonte se do t'i ndihmonte në procesin e tyre gjyqësor kundrejt pagesave që shkonin deri në 2 mijë euro. Në disa raste, ai u mundësonte qytetarëve që pagesat t'i kryenin me këste. Shkak për fillimin e përgjimeve për 60-vjeçarin ishte bërë një sinjalizim në polici i vetë kryetares së Gjykatës së Durrësit, Joana Qelesi, më 30 janar të këtij viti. Informacionet që kishin mbërritur tek ajo për implikimin e këtij efektivi në këtë veprimtari korruptive iu referuan policisë e më pas prokurorisë së Durrësit që nisi hetimin. Numri i telefonit të punonjësit të policisë u vu në përgjim si person në rolin e sekserit të mbetur në tentativë, ku sipas Prokurorisë së Durrësit, doli edhe avokati Devis Qana. Burime nga organi i akuzës bënë me dije për "abcnews.al" se 40-vjeçari Devis Qana dhe Haki Dyli zhvillojnë komunikime të shkurta e më pas takohen fizikisht për shkak se zyra e avokatit është pranë gjykatës. Gjatë bisedës së regjistruar me datë 14 prill 2018, pretendohet se një prokurorë i ka kërkuar 2 mijë euro për të mbyllur një çështje.

B- Po Haki!
A- Hajde, se kam një punë tepër urgjente!
B- Erdha, erdha...
B- ...Ai ishte avokat apo sekser?!
A- ...Mua më tha që do ia pushoj çështjen patjetër.
B- Mua më tha kështu...
Unë do ta mbyll çështjen brenda 2-3 vjetësim-ndalimi dhe caktimi masë sigurimi. Djalin do ta nxjerr të pafajshëm. Do t'ju jap edhe një dokument që djali është i pafajshëm.
A- Kështu më tha edhe mua...
B- Donte 600 mijë lekë për vete dhe 2 mijë euro Prokurorja...
Më herët, më datë 7 mars

Pazaret për proceset gjyqësore, ja si i mashtronin qytetarët polici e avokati

Zbardhen përgjimet/ "I thuaj babit do t'i sjellë 150 unë dhe do t'ia vonoj një cikë atë qindëshen"



Gjykata e Durrësit

MASA E SIGURISË

Efektivi i policisë, Haki Dyli dhe avokati Devis Qana pritet që të dalin sot për njohjen me masën e sigurisë në Gjykatën e Durrësit për veprën penale "Ushttrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike e kryer në bashkëpunim".

rreth orës 10 e 30 minuta, Haki Dyli zhvillon një bisedë telefonike me një person. Polici Dyli i kërkon bashkëfolësit 1 mijë euro, të cilat siç thotë ia, kishte kërkuar djali i punonjësit të Gjykatës së Durrësit.

A- ... Erdhi sot urgjent ai zotëria... tha pasnesër ke 1000 euro. Mirë i thashë, dakord!
B- Erdhi sot urgjent eee?!
A- Po, ai i biri.
B- I biri?
A- E pra, nga Vlora.

Arrestimi i policit, gjykata: Denoncimi, nga kryetarja Qelesi

DURRËS - Një ditë pas arrestimit të inspektorit Haki Dyli ka reaguar Gjykata e Shkallës së Parë e Durrësit ku ai punonte. Sipas kësaj gjykate, ka qenë kryetarja Joana Qelesi, ajo që ka denoncuar efektivin e policisë. Ndërkaq, gjykata e qytetit bregdetar dënon me forcë çdo veprim të paligjshëm të kryer në dëm të qytetarëve dhe punonjësve të drejtësisë, duke treguar vendosmëri në denoncimin e çdo rasti të ngjashëm. "Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës njofton se ndalimi më datë 10.07.2018 i punonjësit të policisë Haki Dyli, caktuar me detyrë shërbimi në sigurinë e godinës së gjykatës nga Policia e Shtetit, është bërë për llogaritë të procedimit penal të nisur mbi bazën e kallëzimit të kryetares, znj. Joana Qelesi. Kallëzimi u krye nisur nga dyshimet se punonjësi i policisë Haki Dyli merret para në emër të gjyqtarëve dhe prokurorëve, pa dijeninë e këtyre të fundit, duke u premtuar dhe mashtruar qytetarët mbi zgjidhjen në favor të tyre të çështjeve gjyqësore", thuhet ndër të tjera në njoftimin e gjykatës.

B- Aaaa ku është aty?
A- Po erdhi e unë nuk e njoha fare, i vajta i thashë lëviz makinën që këtej, kur ai më tha mua nuk po më njeh! ...eee do vij pasnesër.
B- Ashtu tha?
A- Po... do vij vetë tha pasnesër e do të sjellë tha gjysmat e lekëve, do ma bësh hallall tha se nuk kam pas mundësi e kam pas lakun në grykë tha...
Por në një rast tjetër, Haki Dyli tregohet më i kujdesshëm dhe flet me kode.
A- Përsëhendetje!
B Përsëhendetje, si je Haki mirë? Me kërkon ndonjëri aty te gjykata?
A- Jo, të mora unë vetë.
B- Po...
A Tashi dëgjo mua se, ndërmjetësit i kanë këto, kur bëhesh ndërmjetës...
B- Më thuaj...
A I thuaj babit do t'i sjellë 150 unë dhe do t'ia vonoj një cikë atë qindëshen.
B- Po mirë, pa problem i them unë.

Tentuan kalimin ilegalisht të 7 klandestinëve, 2 persona në pranga

LEZHË - Dy persona kanë rënë në pranga, pasi akuzohen se u jepnin ndihmë klandestinëve për të kaluar ilegalisht kufirin. Burime zyrtare nga policia e Lezhës bënë me dije se bëhet fjalë për shtetasit B.G., 46 vjeç, banues në Ishull Shëngjin dhe V.N., 48 vjeç, banues në Pukë. Sipas policisë, këta dy persona u kapën duke tentuar në bashkëpunim me njëritjetrin, t'u japin ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit, 7 shtetasve të vendeve të treta, të cilët u konstatuan brenda një tuneli tek "Rana e Hedhun" në Shëngjin. Materialet procedurale në ngarkim të B.Gjokës dhe V.Ndocit iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë për veprën penale "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit" kryer në bashkëpunim.

44-vjeçari: Më futën në bagazh Sherr me grushte për parkimin, përfundon në spital taksisti

VLORE - Një taksisti i licencuar në Vlorë është dhunuar dy ditë më parë pas një shërri në lagjen "24 Maji" të këtij qyteti. Shkak është bërë vendi i parkimit mes tij dhe një taksisti të palicencuar, në afërsi të stacionit të trenit në Vlorë. Mësohet se 44-vjeçari Krenar Betaj ka marrë plagë në trup dhe kokë dhe për pasojë ka përfunduar në spital. Ndërkaq, Betaj tregoi dje për "GSH" se gjithçka ka ndodhur shumë



shpejt dhe se taksisti i palicencuar me gjithë të birin e kanë goditur dhe futur në bagazhin e makinës. "Ditë për ditë zihemi me taksixhinjtë piratë. Unë po rrija tek bagazhi i makinës, ky person vjen me gjithë djalin e tij dhe më godasin në bagazhin e makinës. Nuk e di me se më kanë goditur, s'mora vesh gjë. Më hoqën dhe këpucët, më thyen dhe syzet. Erdhi policia dhe më çoi në spital. Ky person ka kohë që punon aty, na



Terrorizoi pushuesit në Dhërmi, lihet në burg 23-vjeçari

VLORE - Gjykata e Shkallës së Parë në Vlorë ka lënë në qeli 23-vjeçarin që terrorizoi pushuesit në një lokal në Dhërmi. Për Emiljano Ninën u caktua masa e sigurisë "Arrest me burg" për veprat penale: "Prishje të rendit dhe sigurisë publike", si dhe për "Mbajtje e përdorim të armeve pa leje". Mbrëmjen e së shtunës që shkoi, Nina qëlloi katër herë me pistoletë në mes të diskos. Ai ndodhej në konflikt me disa të rinj të tjerë për arsye ende të paqarta. Por krimat e armës shkaktuan kaos dhe panik tek të pranishmit, që po dëfrreshin orëve të natës. Ambientet e brendshme të lokalit u shkatërruan, kurse Nina u kap ditën tjetër në Tiranë.

TIRANË - Një ditë pasi procesi i vettingut zbuloi se gjyqtari i Gjykatës së Lartë, Admir Thanza ka qenë i dënuar në Itali për vjedhje në grup, Prokuroria e Përgjithshme ka nisur hetimet. 50-vjeçari do të hetohet për akuzën e falsifikimit të formularit të vetëdeklarimit, pasi ka fshehur dënimin e vitit 1999 me 40 ditë burg, marrë në vendin fqinj. Mësohet se hetimi ka nisur nga Seksioni i Dekriminaliz-



Admir Thanza

Fshehu dënimin për vjedhje në Itali, prokuroria nis hetimet për gjykatësin e lartë, Admir Thanza

imit në organin e akuzës. Prokuroria do të sekuestrojë nga Komisioni i Vettingut të gjithë dokumentacionin që u prezantua në seancën dëgjimore ndaj Thanzës. Burimet sqaruan se duhet të pritet vendimi i KPK që të vendoset nëse bëhet fjalë vetëm për falsifikim të formularit të

vetëdeklarimit, apo edhe vepra të tjera penale, si korrupsion etj. Kjo do të vlerësohet pasi të administrohen të dhënat nga KPK dhe ILDKPI dhe më pas do të vendoset se cila prokurori do të hetojë dhe për çfarë vepre penale. Dy ditë më parë, në seancën dëgjimore në KPK u dek-

larua se Admir Thanza është dënuar në Itali për vjedhje në vitin 1999, fakt që vetë gjyqtari e pranoi, por mohoi ta kishte kryer ai krimin në fjalë. Gjithashtu, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar kishte konkluduar se Thanza ka fshehur një procedim penal për

korripsion dhe ka kontakte të papërshtatshme me krimin e organizuar. Ndërkaq, në konkluzionet e ILDKP për gjyqtarin Admir Thanza rezultonte se deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, ka kryer fshehje të pasurisë dhe deklarim të rremë. Me këto përfundime Thanza nuk ka gjasa ta kalojë testin e vettingut.

"I përfshirë në korrupsion, vihet në presion nga struktura kriminale"

TIRANË

Prokurori i Tiranës, Adriatik Cama është përballur dje me vettingun. Seanca dëgjimore në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit drejtohej nga Gentia Tafa Bungo, me anëtarë Suela Zhegun dhe Pamela Qirkon. Prokurori Adriatik Cama ka kaluar në filtrin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, pasi është njëri prej 19 kandidatëve për Këshillin e Lartë të Prokurorisë (KLP). Nga hetimi i KPK ka rezultuar se Cama, ish-prokuror i disa dosjeve me rëndësi, mes tyre "21 janari" nuk justifikon pasurinë, është i korruptuar dhe vihet në presion nga struktura kriminale, pra është i papërshtatshëm për të vazhduar detyrën. Para se të emërohej prokuror i Prokurorisë së Tiranës në vitin 2010, ai ka punuar në Tepelenë dhe në Lushnjë. KPK ka lexuar raportin për prokurorin Cama, ndërsa tha se sipas ILDKP ai ka bërë deklaram të saktë të pasurisë dhe ka burime të mjaftueshme financiare. Por, sipas hetimeve të thelluara të KPK është vërejtur se ka mungesë burimesh për të justifikuar pasurinë. "Sipas ILDKPI, Cama ka bërë deklaram të saktë të pasurisë dhe ka burime të mjaftueshme financiare. Ai ka deklaruar një apartament 76m² me vlerë 3.4 milionë lekë, ndërsa në kontratën e shitblerjes, çmimi është 29 mijë dollarë. Për apartamentin, Cama ka bërë deklaram të pasaktë. KPK ka bërë hetim të thelluar për pasurinë e Camës dhe është vërejtur se ka mungesë burimesh për të justifikuar pasurinë. Adriatik Cama ka deklaruar edhe blerjen e një garazhi. Sipërfaqja që ka deklaruar si garazh është dyqan", - thuhet nga KPK. Të dhënat e analizuara nga BIRN tregojnë se prokurori Adriatik Cama zotëronte pasuri familjare në vlerën e 3.3 milionë lekëve në vitin 2003, kur deklaroi pasurinë për herë të parë. Në fund të vitit 2017, pasuria e tij rezultoi e dyfishuar me një vlerë totale prej 7.9 milionë lekësh. Pasuria e zotit Cama ndahet në 4.8 milionë lekë pasuri të paluajtshme, 1.3 milionë lekë kursime të akumuluara në cash, një automjet me vlerë rreth 1.1 milionë lekë dhe likuiditete në bankë

Bie në rrjetën e vettingut prokurori i "21 janarit", s'justifikon pasurinë

Raporti i DSIK: Adriatik Cama, i papërshtatshëm për detyrën

RAPORTI I DSIK

Sipas këtij raporti, prokurori Cama është i papërshtatshëm për detyrën, pasi është i përfshirë në korrupsion. Korrupsioni është konsumuar në Prokurorinë e Lushnjës kur ka qenë në detyrë. Kur Cama ishte drejtues në Lushnjë së bashku me një prokuror tjetër kanë marrë para nga familjarët e një të arrestuari për kontrabandë. Cama identifikohet si person që vihet në presion nga struktura kriminale dhe është i papërshtatshëm për të vazhduar detyrën.



Adriatik Cama

në vlerën e rreth 700 mijë lekëve. Të ardhurat familjare të prokurorit Cama kapin vlerën e rreth 24 milionë lekëve për të gjitha vitet e deklarimit.

Paga nga funksioni dhe ajo e familjarëve përbën pjesën dërrmuese të të ardhurave, ndërkohë që 6.1 për qind e tyre përbëhet nga të ardhurat nga qiratë. Përveç analizës për rritjen/uljen e pasurisë, strukturën e aseteve dhe të ardhurave, ky raport paraqet dhe kontrollin aritmetik/logjik të deklarimeve të subjektit si dhe "flamujt e kuq" që identifikohen gjatë kontrollit. BIRN kreu kontrollin aritmetik/logjik mbi 14 vite të deklaruarave të zotit Cama dhe asnjëra prej tyre nuk rezultoi me diferencë të pambluara. Megjithatë, BIRN ka evidencuar disa "flamuj të kuq" në analizën e deklaratave të pasurive të zotit Cama, të cilat lidhen me disa kredi bankare, një kontratë huaje dhe burimin e pagartë të një logarie bankare. Më konkretisht, në deklaratën e vitit 2009 subjekti deklaroi blerjen e një ish-parkimi (garazh i përshtatur) për 18 mijë euro. Si burim të kësaj pasurie, Cama deklaroi ndër të tjera edhe një llogari bankare me

vlerë 600 mijë lekë, e cila nuk rezultoi në deklarimet e mëparshme. Një tjetër burim për shtimin e kësaj pasurie, i evidencuar si "flamur i kuq" është huaja prej 6 mijë eurosh me afat 5-vjeçar. Në fund të vitit 2017, rezultojnë të pashlyera

edhe 4 mijë euro. Gjatë viteve 2007-2017, subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë marrë gjithashtu disa kredi bankare pa shpjeguar qëllimin e përdorimit të tyre. Njëra prej kredive bankare në vlerën e 4 milionë lekëve është marrë

REAGIMI I PROKURORIT

Prokurori Adriatik Cama mohoi gjetjet e raportit nga DSIK se vihet në presion nga bandat. Përsa i përket hetimit të dosjes së "21 janarit", Cama u shpreh se nuk është influencuar nga askush. Mohoi edhe akuzat për korrupsion kur ishte në Lushnjë, ndërsa tha se në 1997 kur shteti kishte rënë, ka lëshuar urdhër arreste për krerë bandash. Ai tha se ka punuar me integritet, prandaj kërkon rikonfirmimin në detyrë.

për të shlyer kreditë e tjera dhe një pjesë e saj është mbajtur cash. Duke qenë se ky raport bazohet në të dhëna statistikore të analizuara nëpërmjet një databaze, ai nuk nxjerr përfundime mbi pasurinë e subjektit nëse ajo mbulohet me burime të ligjshme ose jo, por mëton të informojë publikun mbi pasurinë e deklaruar të zyrarit publik nëpërmjet një formati të thjeshtë dhe të kuptueshëm grafik. Prokurori Cama nuk

është kapur me shkelje vetëm për pasurinë, por edhe nga DSIK, pasi sipas raportit, është i papërshtatshëm për të vijuar detyrën. DSIK thekson se Cama është i përfshirë në korrupsion kur ishte në Prokurorinë e Lushnjës. Nga hetimi ka rezultuar se Cama kur ishte drejtues në Lushnjë së bashku me një prokuror tjetër kanë marrë para nga familjarët e një të arrestuari për kontrabandë duke pushuar çështjen.

Nuk justifikoi pasurinë

KPK shkarkon gjyqtarin e Tiranës, Artan Laze

TIRANË - Gjyqtari i Gjykatës së Tiranës, Artan Laze është shkarkuar nga Komisioni i Pavarur të Kualifikimit. Sipas Komisionit, Laze nuk justifikon pasurinë dhe ka kryer deklaram të rremë. Në përfundim të këtij procesi, trupa e përbërë nga Brunilda Bekteshi, Lulzim Hamitaj, Olsi Komici, vendosi: "Në zbatim të nenit d të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, vendosi: Të shkarkojë nga detyra subjektin e rivlerësimit Artan

Lazaj, gjyqtar pranë gjykatës së rrethit Tiranë. Vendimi mund të ankimohej pranë KPA, 15 ditë nga data e publikimit të vendimit të arsyetuar". Komisioni hetoi gjyqtarin vetëm për pasurinë dhe jo për aftësitë profesionale dhe morale, ndërsa Lazaj kërkoi përjashtimin e trupës, por u refuzua. Në seancën e kaluar, trupa e KPK deklaroi se gjyqtari Lazaj kishte fshehur pasurinë, kishte bërë deklarim të rremë. Ndërkohë, në përfundim të seancës së



djeshme, avokati Sokol Hazizaj deklaroi se vendimi do të apelohej në Kolegj, pasi KPK ka bërë shkelje dhe se nuk është luks që të kesh një shtëpi. "Nuk e prisnim shkarkimin. KPK ka bërë shkelje. Të kesh një shtëpi nuk është luks, kështu po shkojmë në devijanca sociale. Ne do t'i drejtohem Kolegjit të Apelit", tha Hazizaj.

Elvis Rroshi pranor se ka falsifikuar formularin e dekriminalizimit

Elvis Rroshi, ish-kryetari i Bashkisë së Kavajës ka pranuar se ka falsifikuar formularin e dekriminalizimit. Ai është shprehur në sallën e gjyqit se e ka plotësuar gabim për shkak të neglizhencës dhe se duhet ishte konsultuar me një avokat. Rroshi ka kërkuar gjykim të shkurtuar, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata. Në formularin e dekriminalizimit, ai kishte deklaruar se nuk kishte precedentë të mëparshëm penalë. Pas verifikimeve të prokurorisë, ai rezultoi të kishte qenë i arrestuar, ndaluar, por edhe i dëbuar nga vende si Zvicra, Italia dhe Gjermania.

Dosjet e viteve 1993-2008, formulari-tip për informim në lidhje me ecurinë e vendimeve

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën me 10 mijë dosje ish-pronarësh, që janë në proces shqyrtimi nga kjo agjenci. Kërkesit janë në qarkun e Korçës. Në listën e përditësuar jepet numri i dosjes dhe data e aplikimit, gjeneralitetet e kërkesit, sipërfaqet e njohura për kompensim, dosjet për pronarët që kanë marrë vendim negativ dhe dosjet që duhet të plotësohen. Dosjet janë të viteve 1993 deri në vitin 2008. Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vënë në dispozicionin të pronarëve formularin-tip, "Informacion në lidhje me ecurinë e dosjes", i cili duhet të plotësohet dhe të dorëzohet në 'Agjenci' për t'u njohur me fazën në të cilën ndodhet shqyrtimi i saj. Agjencia Trajtimit të Pronave është e detyruar që brenda 15 ditëve nga momenti i dorëzimit të kërkesës t'i kthejë përgjigje pronarit në lidhje me ecurinë e dosjes.

FORMULARI

Formulari i aplikimit për informacion në lidhje me ecurinë e dosjes është i ndarë në tri seksione. Aplikanti duhet të plotësojë gjen-

Pronarët në Korçë, ATP merr në shqyrtim 10 mijë dosje

Problematikat, procedurat për t'u njohur me ecurinë e shqyrtimit

eralitet, adresën dhe të jetë i pajisur me mjet identifikimi në momentin e aplikimit. Në seksionin e dytë duhet të jetë përkrahur në mënyrë të saktë se në lidhje me çfarë kërkon informacion pala e interesuar, në këtë rast pronari që ka aplikuar për kthim e kompensim prone. Dhe në seksionin e fundit janë të specifikuar pesë dokumentet që duhet të disponojë pronari në momentin e aplikimit.

APLIKIMI

Për t'u njohur me ecurinë e dosjes, subjekti duhet të dorëzohet dhe të paraqesë dorazi ose me postë pranë ATP-së kërkesën për informim në lidhje me ecurinë e dosjes, fotokopje të kartës së identitetit, dëshmi trashëgimie

- DOKUMENTACIONI QË DUHET TE PARAQISNI**
- Formulari-tip
 - Fotokopje e kartës së identitetit
 - Kopje vendimi nga ish-KKP/AKPP (nëse ka)
 - Dokumente të tjera

dhe prokurë të posaçme. Në faqen zyrtare të ATP-së mësohet se subjekti plotëson kërkesën me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes pranë Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun, në 'Agjenci'. Më pas, kërkesa i kalon zyrës së protokollit, e cila pasi e protokollon, ia dërgon të gjitha kërkesat e ardhura drejtorit të përgjithshëm. Kreu i AKPP-ës ia delegon kërkesat sek-

torit përkatës për ndjekje dhe zbatim. Më pas, sektori përkatës përgatit informacionin e kërkuar dhe njofton subjektin. Në përfundim të shqyrtimit, subjekti paraqitet pranë zyrave të ATP-së për të tërhequr shkresën e kthimit të përgjigjes në lidhje me ecurinë e dosjes ose i dërgohet me postë, sipas kërkesës. Aplikimi për kërkesën për informim mbi dosjen nuk ka kosto.

KORÇË

Nr./Dosjes	Rrethi	Emri (Subjekti kërkuar)	Atesia 2	Mbiemri (Subjekti kërkuar)	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Problematika
1037	KORÇE	NIKO		MALAVECI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1038	KORÇE	THOMA		NINKA		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1039	KORÇE	VANGJEL		BICOLLI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1040	KORÇE	SKENDER		SHAHINASI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1041	KORÇE	PETRIKA		CLUE		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1042	KORÇE	MERDAN		SHAHOLLI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1043	KORÇE	ADRIANA		TAKE		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1044	KORÇE	FLORESHA		KAMENICA		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1049	KORÇE	BASHKIM		METKO		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1050	KORÇE	YLLI		METKO		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1052	KORÇE	NARTE		LENA		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1053	KORÇE	PELLUMB		METKO		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1054	KORÇE	MEDI		METKO		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE

Nr./Dosjes	Rrethi	Emri (Subjekti kërkuar)	Atesia 2	Mbiemri (Subjekti kërkuar)	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Problematika
1055	KORÇE	GURI		LICO		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1057	KORÇE	ADEM		COBANI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1058	KORÇE	MIHAL		BOCKA		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1059	KORÇE	DITAR		LAKO		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1060	KORÇE	IDAIT		ISMALANJI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1061	KORÇE	HAXHI		KASMI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1062	KORÇE	EFTIMI		QIRJO		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1063	KORÇE	GURALI		BRAUSHI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1067	KORÇE	FATMIRA		CINI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1064	KORÇE	ESENA		CIPI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1065	KORÇE	BUJAR		CIPI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1066	KORÇE	ELORA		LAVDARI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1068	KORÇE	AGRON		DHEMBI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE

(vijon)

Shëndetësi

Ndër sëmundjet e ndryshme që prekin stomakun është edhe Gastriti, Ulcera dhe prekja nga Helicobacter pylori. Në stomakun e çdo individi ndodhet acid klorhidrik, helicobacter pylori dhe enzima, të cilat sekretohen nga vetë stomaku, pankreasi, gjëndrat e pështymës në gojë, etj. **Shumë individë që kam konsultuar në lidhje me problemet e stomakut, pasi kanë parë analizat që kanë helicobacter pylori mendojnë se është një bakter që nuk e kanë njerëzit e shëndetshëm.**



Mjeku popullor: Sëmundjet e stomakut, si t'i dalloni dhe zgjidhjet për ju

YLLI MERJA: E bardha e vezës dhe glikoja e arrës, zgjidhje për të kuruar gastritin

Stomaku është segmen ti më i gjerë i tubit tretës, që është i vendosur mes ezofagut dhe zorrës së hollë dhe ka si funksion përpunimin kimik e mekanik të produkteve ushqimore nëpërmjet enzimave. Ndër sëmundjet e ndryshme që prekin stomakun është edhe Gastriti, Ulcera dhe prekja nga Helicobacter pylori. Në stomakun e çdo individi ndodhet acid klorhidrik, helicobacter pylori dhe enzima, të cilat sekretohen nga vetë stomaku, pankreasi, gjëndrat e pështymës në gojë, etj. Shumë individë që kam konsultuar në lidhje me problemet e stomakut, pasi kanë parë analizat që kanë helicobacter pylori mendojnë se është një bakter që nuk e kanë njerëzit e shëndetshëm. Ky bakter ndodhet tek të gjithë njerëzit, por për shkak të faktorëve të ndryshëm mund të çrregullohet niveli i tyre në stomak dhe të krijojë shqetësime.

Gastriti ndodh kur prishet balanca midis acidit klorhidrik në stomak dhe mureve të stomakut. Kjo shoqërohet me dhimbje, djegie, urth, të vjella, ulje oreksi, marrje mendsh.

Ulcera është gërryerje e mukozës mbrojtëse të stomakut, plagë të hapura në stomak, të cilat shkaktojnë dhimbje të forta, të vjella me gjak ose jashtëqitje me gjak. Ulcera shoqërohet me humbje gjaku, anemi, humbje oreksi, humbje peshe, zverdhje në fytyrë etj. Trajtimi i këtyre sëmundjeve të stomakut konsiston në frenimin e pompës protonike, rigjenerimin e mukozës gastrike dhe në ndryshimin e stilit të jetesës.

SI SHKAKTOHET GASTRITI DHE ULCERA

Kur rritet helicobacter pylori ose kur ulet shume pH i stomakut shkaktohet gastriti. Pastaj nëse nuk kurohet në kohe nga gastriti shkaktohet edhe ulcera. Këto sëmundje shkaktohen kur nuk konsumoni vaktet siç duhet. Shumë individë nuk



Mjeku popullor
Ylli Merja

konsumojnë fare mëngjesin, vaktin më të rëndësishëm të ditës, por pinë direkt kafe.

Kafja është shumë e dëmshme sidomos në stomakun bosh, pasi e rrit menjëherë aciditetin e stomakut. Gjith-

ashtu, llumi i kafes shkon në fund të stomakut dhe qëndron aty gjatë gjithë kohës, dhe e gërryen mukozën e stomakut.

Një shkaktar tjetër është qëndrimi pa ngrënë për kohë

shume të zgjatur, p.sh. ngrënia e mëngjesit në 8, dhe pastaj dreka në orën 4-5 mbasditë. Gjithë këtë kohë stomaku fillon të hajë vetveten. Mënyra me e shëndetshme është të konsumo-

hen 3 vakte kryesore dhe 2 herë të tjera diçka e vogël midis.

Abuzimi me alkoolin dhe me pijet e gazuara shkakton çrregullime në stomak. Për të mos e dëmtuar stomakun mund të konsumoni alkool me masë të caktuar pasi keni ngrënë ushqim. Nuk është mirë që alkooli të bjerë direkt në stomak bosh, pasi e gërryen tepër mukozën e stomakut.

Çfarë duhet të konsumojmë kur vuajmë nga këto sëmundje?

Duhet të hahen vakte të shpeshta çdo 3-4 orë edhe nga pak, pasi nuk duhet mbingarkuar stomaku të punojë shumë gjatë, dhe të tretë shumë ushqim. Nuk duhet të konsumohet ushqim pas orës 19.00. Duhet konsumuar ushqime shumë të lehta, pa yndyrë shumë, pa mish të kuq, ushqime të ziera. Këshillohen shumë perimet e ziera, ushqimet jeshile, çdo gjë e zier. Nuk duhen konsumuar ushqime të gjalla sidomos nga njerëzit që vuajnë nga ulcera, pasi stomaku duhet lënë i qetë të

rigjenerojë vetveten. Mund të përdoren supa me mish pule ose peshku, do të ishte mirë të përdoren si pure, jo të pabluara. Pureja me patate është shumë e shëndetshme.

Si mund ta kurojmë stomakun me bimë medicinale?

Gastriti dhe ulcera janë sëmundje që mund të kalohen lehtësisht për dy arsye. E para, sepse janë sëmundje që kapen në kohë, sepse krijojnë shqetësime që dallohen menjëherë, dhe së dyti, sepse shkaktohen nga vetë individi, dhe nëse i mënjanojmë në kohë "gabimet" tona mund t'i shërojmë 100% të dyja këto sëmundje.

Bimët medicinale kanë dhënë efekt në trajtimin e këtyre dy sëmundjeve të stomakut. Si fillim duhet përdorur një çaj 3 herë në ditë i përbërë nga: një pako çaj për stomakun + 3 fije lule basani + 1 dorë mëllagë e zezë. Ziejnë të gjitha në 2.5 litra ujë për 2 min, kullohet çaji pasi ftohet, dhe ruhet në frigorifer.

Në mëngjes esëll pihet një e bardhë veze me qumësht. Gjate ditës do të konsumoni 2-3 kokrra arrë (nga glikoja e arrës), kjo gliko është përgatitur posaçërisht për problemet e stomakut, ka pak sheqer dhe është pak e zier. Gjithashtu, në mëngjes esëll konsumohet një mëngjes i shëndetshëm me një gotë kos, 3 lugë tërshërë, 1 lugë gliko arre, 1 lugë susam i bluar dhe 1 lugë vaj liri. Lihet 5 min të zbutet dhe konsumohet. Pas kësaj pihet çaji. Kjo kure përsëritet për 45 ditë, por edhe me gjatë në rastin e ulcerës.





Foto kolazh nga masakra e Srebrenicës

Dënohen fajtorët, Haga: 699 vjet burg për gjenocid kundër boshnjakëve

13 vite më pas, përkujtohen viktimat e Masakrës së Srebrenicës

Pendohet i dënuari: Nuk mbrojta të burgosurit

Gjykata e Hagës dhe gjykatat vendore në Bosnjë, Serbi dhe Kroaci kanë dënuar 45 vetë me 699 vjet burg - plus tre dënime me burgim të përjetshëm - për gjenocid, krime kundër njerëzimit dhe shkelje të tjera kundër boshnjakëve në Srebrenicë në korrik 1995. Dymbëdhjetë muajt e fundit është parë një tjetër vendim historik që dënoi një figurë të lartë të serbëve të Bosnjës për përfshirje në mizoritë më të këqija në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore - Ratko Mlladić, ish-komandanti i shtabit kryesor të Ushtrisë Serbe të Bosnjës, i cili u dënua me burgim të përjetshëm në nëntor. Duke e shpallur Mlladićin fajtor për gjenocid në vendimin e shkallës së parë, gjykata e OKB-së në Hagë tha se ai kishte "synimin gjenocidal për të shkatërruar boshnjakët në Srebrenicë". Sipas gjyqtarëve, prova e këtij qëllimi ishte mesazhi i Mlladićit për banorët boshnjakë të Srebrenicës, që ata mund të "mbijetonin ose zhdukeshin". Ashtu si Radovan Karaxhić, i cili u dënua për gjenocid në një vendim të shkallës së parë vitin e kaluar, Mlladić ka treguar se do ta apelojë vendimin. Me afrimin e përvjetorit të këtij viti të masakrave të Srebrenicës, gjykatat në Hagë, Sarajevë, Beograd dhe Zagreb kanë dhënë gjithsej 699 vjet burg - plus tre dënime me burgim të përjetshëm - të pandehurve të dënuar për kryerjen e krimeve pas rënies së Srebrenicës në duart e ushtrisë dhe policisë serbe të Bosnjës, të cilët vranë më shumë se 7,000 burra dhe djem dhe deportuan mbi 40,000 gra, fëmijë dhe të moshuar. Gjykata shtetërore e Bosnjës ka miratuar shumicën e vendimeve për krimet e Srebrenicës, duke dënuar 24 vetë; gjykata e Hagës ka dënuar 14 ish-anëtarë të ushtrisë serbe të Bosnjës dhe forcës policore, ndërsa gjyqësori serb ka dënuar pesë persona krime në Srebrenicë. Ndërkohë, sistemi gjyqësor kroat ka dënuar dy ish-anëtarë të njesisë paraushtarake, "Akrepaf". Vendimi i parë që vendosi se në Srebrenicë ishte kryer gjenocid ishte ai që u dha në rastin kundër ish-zv/komandantit të Korpusit të Drinës, të Ushtrisë Serbe të Bosnjës, Radislav Krstić, i cili u dënua me 35 vjet burg se ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e gjenocidit. Gjykata e Hagës arriti në përfundimin se krimi ishte planifikuar në nivelin më të lartë dhe ata që ishin më të përgjegjshëm ishin stafi i Shtabit Qendror të Ushtrisë Serbe të Bosnjës. "Dhoma e quan masakrën në



Varrezat e viktimave në Srebrenicë

I DËNUARI DRAGAN OBRENOVIĆ

"Jam fajtor që nuk bëra disa gjëra, që nuk mbrojta të burgosurit, pavarësisht faktit se isha në një pozicion të përkohshëm. Vazhdoj të pyes veten, çfarë mund të bëja dhe çfarë nuk bëra? Mijëra njerëz të pafajshëm vdiqën. Ka varre, refugjatë, gjithçka është shkatërruar dhe ka trishtim total. Unë mbaj një pjesë të përgjegjësisë për këtë", - tha Obrenović.



Srebrenicë me emrin e saj të duhur - gjenocid. Ata që janë përgjegjës për të do të mbajnë mbi supë barrën dhe kjo do të shërbejë si një paralajmërim për të tjerët që mendojnë kryerjen e një akti të tillë të tmerrshëm", - tha gjyqtari Theodor Meron ndërsa lexoi vendimin për dënimin e Krstićit. Disa vrasës e pranojnë fajin e tyre. Gjykata e Hagës ka dhënë

dënime me burgim të përjetshëm për gjenocid për ish-shefin e sigurisë në Shtabin Qendror të Ushtrisë Serbe të Bosnjës, Lubisha Beara, kreut të saj të inteligjencës dhe sig-

urisë, Zdravko Tolimir dhe Vujan Popović, i cili ishte kreu i sigurisë i Korpusit Drina të ushtrisë. Beara vdiq vitin e kaluar në një burg në Gjermani, ku po vuante dënimin e tij, dhe Tolimir vdiq një vit më parë duke pritur që të dërgohej për të vuajtur dënimin e tij. Ish-ushtari i ushtrisë Serbe të Bosnjës Drazen Erdemović ishte i pandehuri i parë i Srebrenicës që pranoi fajin e tij para Gjykatës së Hagës, duke pranuar se ai kishte marrë pjesë në vrasjen e mbi 1,000 boshnjakëve nga Srebrenica në Branjevo në korrik 1995. Pasi vuajti dënimin e tij dhe u lirua nga burgu, identiteti i Erdemovićit u ndryshua për ta mbrojtur atë. Marko Boskić, një ish-anëtar i Skuadrës së 10-të të Zbulimit të Ushtrisë Serbe të Bosnjës, gjithashtu, pranoi se ishte fajtor për përfshirje në vrasjet në Branjevo dhe u dënua me dhjetë vjet burg në një marrëveshje pranimi fajësie me gjykatën shtetërore të Bosnjës. Boskić siguroi atë që prokurorët e përkrahuan si "informacion të rëndësishëm" mbi ekzekutimet në Branjevo edhe për autorët e tjerë, duke kontribuar në identifikimin dhe gjykimin e tyre. Zv/komandanti i Brigadës së Zvornikut e Ushtrisë Serbe të Bosnjës, Dragan Obrenović, gjithashtu, pranoi se ishte fajtor dhe u dënua me 17 vjet burg nga gjykata e Hagës. Gjykatësit zbuluan se Obrenović ishte në dënimin që anëtarët e brigadës po merrnin pjesë në masakra të organizuara dhe në varrosjen e kufomave. "Jam fajtor që nuk bëra disa gjëra, që nuk mbrojta të burgosurit, pavarësisht faktit se isha në një pozicion të përkohshëm. Vazhdoj të pyes veten, çfarë mund të bëja dhe çfarë nuk bëra?", tha Obrenović në gjykatë. "Mijëra njerëz të pafajshëm vdiqën. Ka varre, refugjatë, gjithçka është shkatërruar dhe ka trishtim total. Unë mbaj një pjesë të përgjegjësisë për këtë", tha ai.

699

VITE BURG

Plus tri dënime me burgim të përjetshëm - të pandehurve të dënuar për kryerjen e krimeve pas rënies së Srebrenicës në duart e ushtrisë dhe policisë serbe të Bosnjës, të cilët vranë më shumë se 7,000 burra dhe djem dhe deportuan mbi 40,000 gra, fëmijë dhe të moshuar. Gjykata shtetërore e Bosnjës ka miratuar shumicën e vendimeve për krimet e Srebrenicës, duke dënuar 24 vetë; gjykata e Hagës ka dënuar 14 ish-anëtarë të ushtrisë serbe të Bosnjës dhe forcës policore, ndërsa gjyqësori serb ka dënuar pesë persona krime në Srebrenicë.

Hetonte ekzekutimin e politikanit serb, dhunohet Cvetković

Trondit gazetari serb: Hetimet për vrasjen e Ivanović, të çojnë në zyrën e Gjuriçit

Gazetari serb Stefan Cvetković, i cili u dhunua pasi po merrte me hetimin mbi vrasjen e Oliver Ivanovićit ka lëshuar një deklaratë të fortë. Ai tha se gjurmët për vrasësin e Ivanovićit të çojnë në zyrën e Gjuriçit. Ai pretendon se vrasësit e Ivanovićit kishin kontakte të ngushta me disa

individë nga zyra për Kosovën në Beograd. "Ivanović është ekzekutuar. Hetimi tregon për ekzistencën e bazuar të dyshimeve se organizatorët e vrasjes së Ivanovićit kishin kontakte të ngushta me individë nga zyra për Kosovën në qeverinë e Serbisë", tha Cvetković, transmeton lajmi.net. Në një konferencë

për media gazetari serb bëri të ditur se ka qenë disa herë në Kosovë, ku ka pasur edhe kontakte me prokurorin special në Kosovë. Në konferencë për media gazetari serb doli me fashë në kokë, pasi dy net më parë ai u sulmua brutalisht në një kafene. Cvetković theksoi se emri e personi që e sulmoi tentoi ta vrasë, por për

të më e rëndësishme është të dijë se kush e dha urdhrin. Ai bëri të ditur se u godit me një shufër metalike. Nga fotografitë që qarkullonin në rrjetet sociale shihej se Cvetković kishte një të carë në sy. Gazetari që po heton vrasjen e Ivanovićit ishte zhdukur më 13 qershor.

SI TË PARANDALONI XHELOZINË MES VËLLEZËRVE E MOTRAVE?

SUMMER

pages


SUPLEMENT I GAZETIA SHQIPTARE

E enjte 12 Korrik 2018



MODERATORJA

Luana 'çmend' ndjekësit
E keni parë ndonjëherë
kaq të nxehtë?



Enca nuk përmbahet,
i tregon gjoksin fansit

BULEVARDI
POLITIK



- Godet sërish Tërmet Peçi, "dorëzon" te turqit kalanë e Ali Pashë Tepelenës
- Basha e merr në telefon, deputeti i PD-së ka mikrofonin e hapur
- Deputetja socialiste habit me dekoltenë e saj në foltoren e Kuvendit
- Ronaldo kalon te Juventusit, deputeti i PS-së, Erjon Braçe: Mbetem tifoz i Mesit



Rëfeket këngëtarja: Jeta ime mes familjes dhe muzikës, pushimet në jug

ORGESA ZAIMI:

Fëmijët i lija dhe i gjeja në gjumë

"Nuk bëj kompromise për famë në tregun ndërkombëtar"

Rrëfëhet këngëtarja: Jeta ime mes familjes dhe muzikës, pushimet në jug

Orgesa Zaimi: Fëmijët i lija dhe i gjeja në gjumë

"Nuk bëj kompromise për famë në tregun ndërkombëtar"

Egla Xhemali

Orgesa Zaimi është një nga zërat më të mirë të muzikës pop rrok në Shqipëri. Këngëtarja vjen në një rrëfim për suplementin "Summer Pages", ku na tregon për pushimet e kësaj vere, raportet me fëmijët, për muzikën e radion si dhe për projektet më të afërta. Në këto ditë të nxehta këngëtarja na thotë se përpos pushimeve në Borsh, do të jetë e angazhuar me muzikë. E pyetur nëse ka vendosur të jetë e rrëptë apo tolerante me fëmijët ajo pohon se ka zgjedhur një të mesme mes disiplinës dhe nënës që mund t'i flitet e t'i tregohet gjithçka. Nëse do i duhej të zgjidhte mes muzikës dhe radios, Zaimi nuk do të donte të arrinte deri në këtë pikë, pasi të dyja e plotësojnë. Sa i përket këngës së fundit "Ngrije zërin", Orgesa është e lumtur për impaktin dhe pëlqyeshmërinë që ka pasur te njerëzit. Kënga vjen si një konglomerat ndjenjash dhe tingujsh e me tekst mjaft motivues. Duket se shumë shpejt do të kemi surpriza nga artistja.

A i ka planifikuar Orgesa pushimet e verës?

Si çdo vit në verë zgjodha jugun e Shqipërisë, Borshi është destinacioni im çdo verë. Veç relaksit a do të ketë ditë dinamike kjo verë? Pushimet i kam të limituara në dhjetë ditë për shkak të punës dhe angazhimeve me muzikën që luaj në Tiranë dhe nëpër rrethe, po ashtu, edhe radios që e kam të përditshme,



por patjetër që e gjej kohën e relaksit kur mungon gjatë fundjavave. **Ju keni dy fëmijë të vegjël, Borën dhe Kronin. Kush ju ngjan më tepër?** Të dy kanë marrë shumë nga unë dhe im shoq, por një ngjashmëri të madhe ka nga unë im bir Kroni, më

duket sikur shoh veten time ndërkohë që ai rritet me shumë energji dhe karakter të fortë e luftarak. **Orgesa është mami tolerante apo e rrëptë?** Jam të dyja nga pak, pa shkuar në ekstreme, kam gjetur një të mesme midis të qenit nënë, që do pak disi-

plinë dhe nënë që mund t'i flitet e tregosh çdo gjë, edhe gabimet. (qesh) Puna zë një pjesë të mirë të ditës suaj. A keni ndonjë peng në lidhje me kohën që u kushtoni fëmijëve?

Ka pasur raste kur agjenda e punës ishte shumë e ngjeshur dhe i lija fëmijët në gjumë e i gjeja në gjumë, por duke pasur parasysh këto "humbje" tani bashkë me tim shoq e ndajmë dhe racionojmë kohën, që të kemi mundësi më shumë me rritjen e tyre vetëm ne të dy.

Vihet re që në veshjet tuaja ju preferoni ngjyrën e zezë. Çfarë domethënie ka ajo?

E zeza është universale dhe e pakohë në termat e modës; e kam vendosur si ngjyrën time të preferuar në veshje prej shumë vitesh tashmë, por ka edhe ndryshime të herë pas herëshme, nëse mund t'ju korrigjoj, këto kohët e fundit jam bërë më shumë solare.

Kënga juaj "Ngrije zërin" vjen si një konglomerat ndjenjash dhe tingujsh. Si është pritur nga publiku?

Kënga ka qenë pjesëmarrëse në "Festivalin e 56-të Këngës" në Radio Televizion. Ka qenë një eksperiencë e bukur, sepse kënga u bë një nga të preferuarat dhe askush nga ne s'e priste, kjo do të thotë që kur kënga është e mirë ajo neqet gjithmonë, mua më përfaqëson dhe me sa e kam



si artiste dhe nuk do doja që të arrija deri aty sa të zgjidhja midis tyre, shpresoj mos të jem e detyruar pasi i dua të dyja njësoj.

Keni menduar ndonjëherë që muzika juaj të kapërcejë tregun kombëtar?

I kam bërë, në fakt, provat për këtë gjë në vitin 2014 me albumin tim "Brand New Day", që është i gjithë në anglisht dhe ska qenë fushë me lule, patjetër që një këngëtar ka dëshirë që muzika e tij të bëhet universale edhe unë nuk ngelem mbrapa kësaj dëshire dhe e synoj, por brenda kushteve dhe



bërë balancën ka më shumë po sesa jo në pëlqimet e njerëzve madje të shumtë këmbëngulin që është nga ato këngë që vijnë një herë në jetë. Por unë them që kam akoma më shumë për të dhënë në muzikë.

Nëse do ju duhej të zgjidhnit mes muzikës dhe radios, cilën do preferonit?

Të dyja më plotësojnë si person dhe

mundësive pa bërë asnjë kompromis e mbi të gjitha pa dalë nga vetja.

Cilat janë projektet tuaja më të afërta? Kur do kemi surpriza nga Orgesa?


Shumë shpejt do të publikoj një këngë të re... por dua të mbarojë vera dhe në vjeshtë të nis punën në studio, deri atëherë më uroni fat!

Ju urojmë fat!




E keni parë ndonjëherë kaq të nxehtë? Luana 'çmend' ndjekësit

Moderatorja shqiptare Luana Vjollca pas suksesit që përjetoi me këngën "Mi dhe flakë mallit tim" ka nisur disa ditë pushimi larg Shqipërisë. Bukuroshja bionde ka qenë shumë aktive në rrjetin sociale "Instagram" ku dhe ka pa publikuar momente nga pushimet e saj. Mesa duket ky sezon veror e ka gjetur mjaft në formë Luanën, pasi ajo shfaqet me linja perfekte, më e dobët dhe e palestruar si asnjëherë më parë. Luana i ka çmendur të gjithë ndjekësit teksa ka publikuar një foto që i ka lënë të gjithë pa fjalë. E veshur me një palë bikini të vogla bardhë e zi, Luana shihet mbi një jaht, teksa pozon duke i treguar të gjithëve trupin seksi dhe format bombastike.




Enca nuk përmbahet, i tregon gjoksin fansit

Trendi më i ri në rrjetin social "Instagram", ku ndjekësit bëjnë pyetje dhe përgjigjet postohen në "Instastory", duket se ka fiksuar edhe VIP-at shqiptarë. Së fundmi, kësaj loje iu bashkua edhe Enca, e cila ka filluar t'u përgjigjet pyetjeve të fansave të saj. Mirëpo, vëmendjen e të gjithëve e ka tërhequr pyetja e një ndjekësi, i cili i shkruante këngëtares:



"Një nga ëndrrat e mia më të mëdha është të shoh thithkat e tua. Kur do të na i tregosh të lutem?" Enca ka habitur fansat kur menjëherë i ka treguar ndjekësit gjoksin e saj të vizatuar, gjë e cila me siguri e ka lënë fansin me gisht në gojë.



Era Istrefi, gati për finalen e Botërorit

Kampionatit Botëror të Futbollit po i vjen fundi dhe në datën 15 korrik do të mbahet finalja e madhe në Rusi mes Francës dhe skuadrës së radhës që do kualifikohet në gjysmefinalen e sotme. Kënga zyrtare e këtij botërori këndohet nga këngëtarja shqiptare Era Istrefi, Nicky Jam dhe Will Smith. Tre këngëtarët nuk ishin të pranishëm në ceremoninë e hapjes, por lajmëruan që në finale ata do të këndojnë në Rusi. Finalja e madhe po




afron dhe Era Istrefi ka treguar nëpërmjet një postimi se mezi po pret të jetë në Rusi. Ajo ka shpërndarë një foto të stadiumit dhe përmbi të e emocionuar ka shkruar: "Shihemi shumë shpejt Rusia".



Fjolla Morina shfaqet seksi, ja si duket ajo

Keto ditë këngëtarja e njohur Fjolla Morina tërhoqi vëmendjen e të gjithëve kur publikoi në profilin e saj në "Instagram" disa foto ku shfaqej me kostum blu në tualetin e meshkujve. Menjëherë pas publikimit të fotove, fansat filluan ta kritikonin këngëtares për pamjet që kishte postuar, mirëpo, pozat e saj nuk janë ndalur me aq. Fjolla i ka bërë të gjithë të flasin me vete, teksa ka pozuar e ulur në tualet me këmbët hapur, me geta dhe



me gjoksin e ekspozuar në dekoltenë e hapur, duke u dukur mjaft provokuese dhe seksi.





Çfarë mund të bëjnë prindërit për ta parandaluar xhelozinë e fëmijëve të tyre? Para së gjithash duhet ta shohim xhelozinë në këndvështrimin e zhvillimit: është një përjetim që bën pjesë në përvojën e vëllezërve e motrave. Duhet t'i vëzhgoni fëmijët tuaj, t'i mirëkuptoni dhe shoqëroni në këtë fazë...

Kuptoni dhe shoqëroni

Xhelozia bën pjesë në marrëdhënien me vëllezërve e motrave: është një ndjenjë normale e pavetëdijshme e sjelljes së tyre. Të gjitha veprimet e tyre duhet t'i shihni jo si teka dhe sjellje të gabuara, por si një nevojë për vëmendje.

Shihni anën pozitive

Marrëdhënia vëllazërore është një mundësi e madhe për zhvillimin psikologjik e social të fëmijëve. Të mësoni të menaxhoni xhelozinë është një kompetencë që në të ardhmen do të jetë shumë e nevojshme për fëmijët. Bëhet fjalë për një ndjenjë që lind spontanisht dhe në mënyrë të pavetëdijshme.

Nuk është e nevojshme ta mbingarkoni me fjalë pa fund e arsyetime të lodhshme, sepse fëmija nuk kupton me arsyetim, por nëpërmjet përvojave që kalon. Për të ndihmuar të vegjlit ta largojnë këtë ndjenjë, duhet të kenë një stil edukativ, i cili i lejon disa përvoja që përmbajnë momente të vështira.

Jepni secilit gjithçka që ka nevojë

Çdo fëmijë ka personalitetin e tij: nuk është e vërtetë që prindërit duhet t'u garantojnë të njëjtat gjëra fëmijëve. Nëse blini çokolata, nuk është e thënë që t'i jepni dy njërit fëmijë dhe dy tjetrit: secili dëshiron që të shihet si personi unik e i çmuar që është, në bazë të shijeve të veta personale dhe karakterit që ka. Për shembull, njërit prej fëmijëve mund t'i pëlqejë që të ftojë shokët në shtëpi, ndërsa tjetrit që të qëndrojë ulur në divan duke parë filmat e tij të preferuar.

Me pak fjalë, rregulli qëndron që t'i jepni secilit fëmijë atë çka ai ka nevojë, atë që e bën të ndihet i pranuar dhe në qendër



Si të parandaloni xhelozinë mes vëllezërve e motrave?



të vëmendjes suaj.

Rregulla të qarta

Nuk shërben që ta qortoni apo

ta dënoni. Nuk shërben që ta çoni në një cep dhe ta përbuzni, por ta stërvitni ndaj rregul-

lave. Një strategji e mirë për të qetësuar grindjet që vijnë si pasojë e xhelozisë, është ta



çoni në dhomë që të reflektojë për sjelljen e tij, në mënyrë që më pas të vijë e të kërkojë falje.

Prindërit janë gjithmonë një model edukues që i ndihmon fëmijët të verbalizojnë, të reflektojnë dhe të gjejnë zgjidhje. Nuk është e shëndetshme që prindërit të mos reagojnë, duke menduar se më pas fëmijët do t'ia dalin vetë mbanë në mënyrë spontane. Të vegjlit duhet të jenë të shoqëruar në brendësi të marrëdhënive me njëritjetrin.

Mos etiketoni

Kurrë mos bëni krahasime dhe diferencime. "Ti je i keq, vëllai yt është zemërmirë", "Ai shkon mirë me mësime, ndërsa ti jo". Janë shprehje që duhen evituar në çdo rast, pasi rrezikojnë shumë vetëbesimin e fëmijëve dhe mbi të gjitha ndezin tek ata ndjenjën e inatit e rivalitetit.

Mos u trembni

Xhelozia është normale: nuk duhet të shkurajoheni, nuk duhet të jeni të ashpër e autoritarë, sepse kjo sjellje nuk shërben për asgjë. Duhet thjesht të mirëkuptoni, të gjeni burimin e kësaj xhelozie e të veproni me gjakftohtësi e racionalitet. Dhe mbi të gjitha duhet t'u qëndroni shumë pranë fëmijëve tuaj.

Godet sërish Tërmet Peçi, "dorëzon" te turqit kalanë e Ali Pashë Tepelenës

Otomanët e djeshëm e vranë Ali Pashë Tepelenën duke i prerë kokën, për të frenuar në këtë mënyrë përpjekjet e tij në ndërtimin e një shteti të pavarur shqiptar.

Por sot kohët kanë ndryshuar aq shumë, sa çuditërisht në jo pak raste kemi dëgjuar të flitet për 'vëllazëri' me turqit e sotëm. Në kuadër të kësaj klime ndodhin edhe gjëra që ndoshta s'mund të imagjino-heshin shekuj më parë. Si për shembull 'dorëzimi' i kalasë së Ali Pashë Tepelenës tek turqit për restaurim. Një ditë më parë kryebashkiaku Tërmet Peçi priti në zyrë ambasadorin turk në Tiranë, Ahmet Yörük. Peçi i kërkoi atij ndihmë për restaurimin e kalasë. "Së fundmi dua të kthehem në diçka më konkrete, çka është vërtet e nevojshme pasi kemi gati 17 projekte në fushën e infrastrukturës, ku midis tyre do veçoja projektin e kalasë së Ali Pashës, si një nga "armët" me të forta për zhvillimin e turizmit në Tepelenë"... u shpreh Peçi gjatë takimit me diplomatin turk. Ndërsa ambasadori ja ktheu: "Propozimi juaj për kalanë e qytetit më pëlqen shumë dhe jemi të hapur për të financuar në ruajtjen e trashëgimisë së përbashkët".



Basha e merr në telefon, deputeti i PD-së ka mikrofonin e hapur

Ndonëse qëndron vetëm 2 radhë më pas në sallën e Kuvendit, Lulzim Basha e ka marrë në telefon kreun e grupit parlamentar, Edmond Spaho t'i komunikojë planin për bllokimin e seancës. Gjithçka ka ndodhur në fund të seancës të se enjtes ku u votua me votat e shumicës projektligji për prishjen e Teatrit Kombëtar. Pasi përfunduan diskutimet Spaho kërkoi fjalën për procedurë. Kryetari i Kuvendit, Ruçi e ka miratuar dhe teknika i ka hapur mikrofonin. Kjo e ka gjetur Spahon të papërgatitur. Në këto momente ai po fliste në telefon me kryetarin e partisë, ndërsa në sallë dëgjohej fjalët: "Po nëse nuk e tërheqin projektligjin...". Kjo ka shkaktuar ilaritet në sallë, ndërsa kryetari i Kuvendit i është drejtuar sërish: "Mund të flasësh tani që more porosinë".



BULEVARDI

Na merrni seriozisht! 😊

POLITIK



Deputetja socialiste habit me dekoltenën e saj në foltoren e Kuvendit

Deputetja socialiste, Elisa Spiropali, një ndër mbështetëset më të flakta të kryeministrit Edi Rama tërhoqi vëmendjen e fotografëve dhe kamerave, në një nga seancat e Kuvendit pak javë më parë. Në fakt, teksa kishte marrë fjalën në foltore, sytë e të pranishmëve dhe jo vetëm shkuan edhe te dekolteja paksa e hapur e ligjvënës, ndoshta pak e tepruar për sallën e një institucioni zyrtar. Prej kohësh shumica e deputeteve në Kuvend zgjedhin të veshin gjatë seancave fustanet apo kostumet më tërheqëse dhe më të shtrenjta, duke ditur se edhe syri i kamerave dhe aparateve fotografike fokusohet pikërisht në këtë pikë çdo ditë të enjte, kur është bërë zakon që të zhvillohen seancat parlamentare.



Ronaldo kalon te Juventusit, deputeti i PS-së, Erjon Braçe: Mbetem tifoz i Mesit

Pas zyrtarizimit të Kristiano Ronaldos si futbollist i skuadrës së Juventusit, ka reaguar deputeti i PS-së, Erjon Braçe. Me anë të një postimi në "Instagram", Braçe shkruan se transferimi i "CR7" është një blerje e madhe, por duhet parë se si do të funksionojë ekipi.

Por edhe pse është portugezi ai që kaloi tek Juventusit, deputeti socialist shkruan se pavarësisht të gjithave, mbetet tifoz i Mesit. Deputeti i PS-së, Erjon Braçe, është i njohur për mbështetjen që i jep në rrjetet sociale skuadrave të tij të zemrës, Partizanit dhe Juventusit.



TEATRI

Artistët, letër Brukselit: Korrupsion me ligjin e teatrit

Informacioni drejtuar Mogherinit e Hahn thekson shkeljen e ligjeve dhe mungesën e Gjykatës Kushtetuese

Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit u ka dërguar një letër disa prej zyrtarëve më të lartë europianë që merren me zgjerimin dhe integrimin e BE, si edhe ambasadoreve të vendeve anëtare të BE në Tiranë. Në të, pasi renditen ato që cilësohen si shkelje ligjore në miratimin e ligjit që i hap rrugë shembjes së Teatrit Kombëtar, vihet në dukje edhe se në Shqipëri, në kohën që flasim nuk ka një Gjykatë Kushtetuese, çka e bën të pamundur ankimmimin. Letra që i shkon Johannes Hahn dhe Federica Mogherinit, e vë theksin tek "aktet korruptive", protesta 5-mujore dhe shton se "konflikti nuk ka të bëjë asfare me gjëra emocionale artistësh, etj. Por ka të bëjë me standardet europiane të konkurrencës së lirë e transparencës në trajtimin e pronës publike nga qeveria dhe mbrojtjen e kësaj prone nga korrupsioni dhe krimi".

LETRA

-Drejtuar: SH.T.Z. Johannes HAHN

Komisioner Europian për Politikën e Fqinjësisë dhe Negociatat për Zgjerimin
-SH.S.Znj. Federica Mogherini

Përfaqësuese e Lartë e Bashkimit Europian për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë

SH.S.Zj. Romana VL-LAHUTIN

Përfaqësuese e Misionit të Bashkimit Europian në Shqipëri

-Përfaqësuesve të misioneve diplomatike në Shqipëri të vendeve anëtare të Bashkimit Europian

Objekti: Informacion në lidhje me paligjshmëritë në miratimin e ligjit: "PËR-CAKTIMIN E PROCEDURËS SË VEÇANTË PËR NEGOCIIMIN DHE LIDHJEN E KONTRATËS ME OBJEKT "PROJEKTIMI DHE REALIZIMI I PROJEKTTIT URBAN DHE GODINËS SË RE TË TEATRIT KOMBËTAR".

Të nderuar zonja e zotërinj,

Duke ju siguruar për konsideratën më të lartë për ju dhe punën tuaj, dëshirojmë që përmes kësaj letrë, t'ju informojmë në lidhje me miratimin nga ana e Parlamentit të Shqipërisë të Ligjit: "Për caktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe lidhjen e kontratës me objekt "Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar", si dhe njëkohësisht t'ju shprehim mendimin tonë mbi shkeljet e rënda që përmban ky ligj. Kuvendi i Shqipërisë, në mesnatën e të Enjtes datë 05.07.2018 miratoi ligjin e sipërcituar, i cili sanksionon



kalimin tek një kompani private e përcaktuar në ligj me emër, të hapësirës publike në qendër të Tiranës, në zonën ku sot gjendet Teatri Kombëtar. Që nga momenti i prezantimit të idesë, në vend ka pasur një reaktion publik, për shkak të faktit që një iniciativë ligjore e tillë qëndron kundër parimeve kushtetuese dhe morale, mbi të cilat është ngritur dhe funksionin shteti shqiptar. Për rreth një muaj rresht, artistë, personalitete të artit dhe kulturës, aktivistë të shoqërisë civile, njerëz të letrave, gazetarë, aktorë politikë dhe qytetarë të shtetëzuar kanë protestuar në mënyrë demokratike në oborrin e Teatrit Kombëtar kundër kësaj iniciative. Njëkohësisht, mbi pesë mijë qytetarë kanë firmosur një peticion drejtuar Presidentit, Kryetarit të Kuvendit dhe një sërë personalitetesh vendimmarrës të vendit, duke iu bërë thirrje që të

ndalojnë këtë iniciativë ligjore që në fakt vetëm ligjsh-mëri nuk ka. Procesi i firmosjes vazhdon dhe do ju dërgohet edhe Juve një kopje e peticionit në përfundim të tij. Sikundër e theksuam dhe më lart, ligji i miratuar shkon kundër parimeve kushtetuese dhe parimeve morale mbi të cilët shqiptarët kanë vendosur të ngrenë shtetin e tyre.

Së pari, ky ligj shkel parimin kushtetues të "Barazisë përpara ligjit" përcaktuar në Nenin 18 të Kushtetutës. Ligji në fjalë me mënyrën sesi parashikon përfituesin (kompani private e përcaktuar në ligj me emër -rast i paprecedentë ky) në veprimtarinë ekonomike që rrjedh prej tij, shkel njëkohësisht parimin e barazisë përpara ligjit dhe parimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike të shtetasve (e cila sanksionohet në nenin 11, pika 1 të Kushtetutës) pasi paracakti

mi i operatorit ekonomik, i cili do të ngarkohet për kryerjen e aktivitetit ekonomik, pa ju nënshtruar konkurrencës, por me përcaktim të drejtpërdrejt në ligj, privon lirinë e veprimtarisë ekonomike për shtetasit e tjerë, vendas apo të huaj, që do të dëshironin të konkurronin për një mundësi veprimtarie ekonomike.

Së dyti, me këtë ligj shkel parimi i sanksionuar në nenin 4 pika 1 të Kushtetutës: "E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit". Që do të thotë se asnjë institucion shtetëror nuk mund të veprojë jashtë kompetencave të tij ligjore dhe kushtetuese, sepse ato përbëjnë bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së atij institucioni.

Ndaj dhe kemi bindjen se parlamenti ka dalë jashtë kompetencave të tij ligjore dhe kushtetuese në miratimin e këtij lloj ligji. Nuk mund të miratohet një ligj për një

emër të veçantë. Ky projekt i takon Bashkisë Tiranë, Ministrisë së Kulturës, ose vetë Këshillit të Ministrave, por jo parlamentit. Parlamenti ka miratuar ligje të përgjithshme se si, qeveria apo pushteti vendor duhet t'i realizojnë këto projekte, por jo vetë parlamenti realizon një projekt konkret me ligj, duke anashkaluar ekzekutivin në shkelje të parimit kushtetues të ndarjes së pushteteve. Së treti, kjo formë veprimtarie ekonomike e parashikuar kështu në këtë ligj, vjen në kundërshtim me standardet e Bashkimit Europian, ku ne aspirojmë të integrohemi dhe konkretisht me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) të nënshtruar dhe ratifikuar nga Shqipëria, ku sanksionohet detyrimi i shtetit shqiptar që kontratat publike të nënshtrohen konkurrencës së lirë dhe transparencës (nenet 70 - 77 të saj). Me këtë ligj ky standard europian i detyrueshëm për ne, është shkelur.

Për ta konkretizuar se përse ligji në fjalë vjen në kundërshtim me standardet e detyrueshme të MSA (nenet 70 - 77) po sjellim si shembull ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "PËR PROKURIMIN PUBLIK" i ndryshuar.

Në nenin 4 të ligjit për prokurimin publik parashikohen përjashtimet nga procedurat e këtij ligji. Pra, parashikon se në cilat raste kontratat publike nuk i nënshtrohen konkurrencës. Deri në vitin 2012 në këtë nen, si përjashtim ka ekzistuar dhe një fjalë "dhe ato që

rregullohen me ligj tjetër". Pra, deri më 2012 lejohej që, me ligje të tjera të parashikoheshin kontrata publike, të cilat si përjashtim nga ligji i prokurimeve të mos i nënshtroheshin konkurrencës.

Por me ndryshimin e vitit 2012 që ju bë ligjit të prokurimeve kjo fjalë u shfuqizua. Dhe konkretisht me ligjin nr.131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, hiqen fjalët "dhe ato që rregullohen me ligj tjetër". Dhe kjo ka ardhur si rezultat i presionit ndërkomëtar për t'iu përshtruar standardëve të MSA. Kështu që, si përfundim, vetë parlamenti me ligj i ka hequr të drejtën vetes të miratojë me ligje të veçanta kontrata publike jashtë procedurave të konkurrencës sipas ligjit të prokurimit publik.

Nëse do të lejohej ky precedent në fushën e ligjërjes atëherë çdo mazhorancë do të miratonte ligje personale pa kufi dhe nuk do të mban-te asnjë përgjegjësi në lidhje me abuzimet, pasi do të justifikohet pas kartonave të parlamentit. Një diskutim tjetër është ai i relativizimit të problemit në fjalë nga mbrojtësit e ligjit (qeveria). Ata e paraqesin sikur ky është një problem emocional, nostalgjik, problem artistësh, kushte pune etj., etj. Ju theksojmë se konflikti nuk ka të bëjë asfare me gjëra emocionale artistësh, etj. por me standardet europiane të konkurrencës së lirë e transparencës në trajtimin e pronës publike nga qeveria dhe mbrojtjen e kësaj prone nga korrupsioni dhe krimi. Duhet sh-tuar këtu edhe fakti që jemi me një Gjykatë Kushtetuese jo funksionale dhe ky është një ligj me vep- rim të menjëhershëm ndaj dhe praktikisht mohohet e drejta themelore e ankimmimit në gjykatë.

Nisur nga këto, duam t'ju kërkojmë edhe një takim në lidhje me çfarë kemi parashtruar në këtë letër dhe t'ju informojmë se angazhimin ynë qytetar do të vazhdojë me të njëjtin intensitet, me protesta të përditshme me qëllim që të kujtojmë çdo ditë kush është interesi i publikut të gjerë.

Me konsideratë të lartë, Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit

Elia Zaharia: Kam firmosur për teatër të ri, jo për shembjen e godinës

Aktorja Elia Zaharia Azogu, ka reaguar sërish për çështjen e firmës së saj në atë që u cilësuar si dokumenti i artistëve që duke kërkuar ndërtimin e një Teatri të ri Kombëtar, po kërkonin shembjen e atij ekzistues. Përmes një postimi në "Facebook", bashkëshortja e Princ Lekës, ka shkruar se ajo ka firmosur për një teatër të ri, por jo për shembjen e këtij që është. "Miq të nderuar. E shoh të udhës të sqaroj edhe njëherë pozicionin tim lidhur me çështjen e Teatrit Kombëtar, pasi konstatoj se emri im në jo pak raste

po keqpërdoret. Unë kam shprehur mbështetjen time ndaj deklaratës së kolegut tim Artan Imami ku kërkohet një Teatër Kombëtar bashkëkohor, në të cilin të performohet në kushte njerëzore, duke theksuar që territori i Teatrit Kombëtar të mos cenohet në asnjë centimetër, por të mbetet tërësisht në funksion të tij", shkruan ajo. Shton më tej se "në letërn e hapur nuk përmendet në asnjë paragraf shembja e teatrit. Arkitektura nuk vihet në diskutim pasi është çështje që i takon specialistëve. E rrikthejoj që nuk kam vënë asnjë firmë për shembjen e teatrit dhe askush



nuk ka falsifikuar firmën time pasi nuk bëhej fjalë për të firmosur fizikisht, por për të mbështetur një deklaratë, ku

shprehej mendimi në lidhje me këtë çështje. Me respekt, Elia", - mbyllet shënim i saj.

KRITIKA

Një burleskë e çlirët, pa dorashka, që të kujtonte të gjitha llojet e ngjashme të komedive popullore të rrugës, oborreve e fshatrave, ku kërcet "gallata", "hajgarja"

Iliria, Shqipëria dhe "Nata e dymbëdhjetë"

Nga Josif Papagjoni

Tëksa shkoja në teatrin antik të Butrintit në edicionin e 16 të Festivalit, një grimë herë mendova se do të kishte pak spektatorë. Ky festival ka ardhur përherë duke u pakuar, lëngata e keqkuptimeve, xhelozive dhe mungesës së vizionit të shumëkujt për t'ri krijuar hapësirën e domosdoshme promovuese e financiare, duket sikur e ka shtrirë përtokë dhe ai tashmë zvarritet si i përgjakur duke lëpirë plagët dhe të çarat nga shpatat e akulturës dhe kokëboshësisë së kohës. Dhe kam kujtuar apogjenë dhe netët e ndritura të këtij festivali, kur kemi parë shfaqje të mrekullueshme, përvojëdhënëse, që na kanë mësuar me epërinë e tyre, nga grekët më së pari me tragjeditë e të mëdhenjve të antikitetit, nga polakët, francezët, italianët, serbët, rusët, e pastaj nga shumë të tjerë si maqedonasit, izraelitët, spanjollët, maqedonasit, bullgarët etj. Disa nga ato shfaqje i kam në kokë si dritë e leksione, sepse pa e ditur as vetë, ligjësitë e teatrit janë ulur vetiu aty në vetëdijen time, si libra të mëdhenj mësimdhënës duke të nxënë shumëçka nga përkryerja e artit. I them këto me dhimbje tek sa e shoh se ky festival çdo vit e më tepër rrrudhet, mpaket, katandiset "kokoshi një thelë". Ai rrrudhet e mpaket, por spektatorët e duan. Një kontradiktë e habitshme. Në prezantim të këtij edicioni, më pëlqeu një fjalë e prof. Përparim Kabos: Ne jemi një popull teatri, jo stadiumesh, duke nënkuptuar me këtë se ne jemi, pra, një popull që duam dijen, idetë, kulturën, mendjen e selitur, jo klithmat e stadiumeve, argëtimin pa ide, cipën dhe syprinën e kënaqësisë. Teatrin ku artikullohet filozofia dhe mendimi e bënë grekët, amfiteatrin ku gëlon argëtimi dhe instinkti e bënë romakët. Por vallë vërtet jemi një popull teatri? E dyshim të kjo pyetje. Por, nëse e kthejmë atë te qeveritarët dhe ata që kanë fuqinë e financës, unë them se jemi me tërësi një lukuni argëtuese, ku të mbyti kich kultura, cipa farfuritëse e spektakle kot, humori kot, gjësend kot, të ashtuquajturit VIP-a kot, të shumtat ca vajza të reja që s'din të flasin (por flasin me shumë trupat e tyre, idiotësia e tyre), ose surrogatë kësaj që gjenden me shumicë në tregun banal të argëtimeve.

Po kthehem aty ku e nisa: duke u futur në shkallaret e teatrit antik të Butrintit pas një orë spektatorësh dhe një hop u tremba se mos shfaqja dështonte. Ishte ngrysur. Por jo, ishte thjesht një frikë e imja. Njerëzit vinin trumba-trumba dhe shkallaret u mbushën përplot. Ai festival ka shijen e antikës, ka një vend të mrekullueshëm e të papërsëritshëm për çdokënd se ku jepet shfaqja, jam i bindur se aktorët provojnë aty një farë hipnotizimi, një farë magjie, pasi mendja e tyre bledh tutje e shkrihet vetiu me kohën e miteve, vetëmitozhet në një transhendencë mbushur me kënaqësi. Po e njëjta gjë i ndodh edhe spektatorëve, mendoj unë, edhe pse janë të një kohe mbushur me makina e autostrada, teknologji të lartë, internet e celularë. Kjo është një arsye përse ky festival duhet të vazhdojë. E dyta është arsye edhe më madhore: mundësia e një përfaqësimi dinjitoz të Shqipërisë përmes një festivali të formatit të tillë, ku kushtet dhe premisat janë të papërsëritshme për të realizuar ballafaqime përvojash teatrore nga mbarë bota, posaçërisht nga Evropa. Kjo mund të ishte festa më e madhe teatrore e hapësirës shqiptare. Por ku s'ka para, gjithçka zh bëhet, zvjerdet, vërret. Sa keq! Si projekt privat ky festival po

Trajtim regjisorial interesant i karaktereve shekspiriane, përndritur nga një vesk i thukët shqiptar



shkon drejt shuarjes. Nuk i kuptoj arsyet, paafësi është apo xheloz, mungesë vizioni nga sponsor të fuqishëm qeveritarë apo meskinite-ti i faktorit financiar privat. Kushdo qoftë, them se kërkohet një zgjidhje nga vetë Ministria e Kulturës, e cila duhet të shtrijë dorën jo thjesht për një grusht parash, por për një rikonceptim dhe rivlerësim të festivalit, të mënyrës së funksionimit të tij, gjer dhe të mënyrës së drejtimit dhe menaxhimit...

Shfaqjen "Nata e dymbëdhjetë", komedi e Shekspir, si shfaqja hapëse e festivalit, e kam parë në shumë variante, me trupa të huaja apo shqiptare dhe mes tyre dritëson sigurisht versionin e Pirro Manit në vitin 1982, në skenën e Teatrit Kombëtar Mirëpo kjo çka pashë në versionin e Metropolit më dha shijen e ëmbël të një koncepti regjisorial original, risemantizues, ku më fort qasja lirike, poetike dhe ndonjëherë dramatike e tekstit shekspirian ishte shmangur duke i mëshuar haresë, atmosferës

gazmore që sillte një shpurë harrakatësh, sherxhinjsh, moskokëçarësh, që sajonë lodra për të argëtuar veten dhe shpotitur budallenjtë e radhës. Prandaj dhe regjisori ishte hepar kah një burleskë e çlirët, pa dorashka, që të kujtonte gjithë llojet e ngjashme të komedive popullore të rrugës, oborreve e fshatrave, ku kërcet "gallata", "hajgarja" dhe çuditërisht ajo të rremben edhe ty. Edhe ti hyn aty në të rreth gaztorësh harrakatë, edhe ti i heq maskat e tjetërsimeve të shumëfishta e lodhëse të jetës, edhe ti i flak konvencionet tutje, e flak sqimën prej zyrtari a "intelektuali", zbrit nga shkallët

e hierarkisë së zymtë dhe kridhesh mes gazit. Kjo lirshmëri, ky shpengim ngjan se është zgjidhja fatlume për vetë shfaqjen, e pëlqeshme në vetvete dhe e hedhur në një tokë tjetër; jo aq shekspiriane kur e kundron në kohën e hershme, e megjithatë shekspiriane kur e kun-



dron në kohën e fundme. Afërmendsh se mua do të më pëlqente edhe spikama e mrekullueshme poetike e veprës, ato mendime të arta që aty gjen, ato theksa filozofike për jetën dhe dashurinë, dhe shumëçka tjetër; do të më pëlqente, herë-herë, edhe ai ritëm e ajo kanilenë e bukur e vargut; do të më pëlqente pastaj edhe ajo shtrësë lirike, që komedia e bart në thelbin e saj me dashurinë e dy çifteve: Duka Orsini, Olivia dhe vëlla e motër; Cezari dhe Viola, më tutje keqkuptimet që ngjasin, pajtimet, zgjidhjet e befta dhe një "deus ex machine" në fund, kur skena dhe jeta mbushen plot dritë e

lumturi. Por... por... Jo gjithçka shkon sipas midesë tënde. Dhe këtu nis vlerësimi kritik, sikurse afrimi drejt stilit dhe leximit regjisorial.

Syri i regjisorit Justin Anderson ishte ngulur pikërisht në dy rrafshë. Rafshi i parë ishte hareja, le ta quaja "komosi" i komedisë greke, gëzimi dhe harrakatja fshatarake e jetës; jo aq sqima e aristokratëve nëpër oborre fisnikësh, dukësh e baronësh, princash a mbretërisht, ku shakaja bëhet pakëz më e rafinuar. Gjithsesi jemi në komedi dhe Shekspiri luante aq bukur me situatën, sikurse edhe me tipa të lëshuar, moskokëçarës, burracakësh a frikakakësh, siç është shpura e sër Tobit me shokë. Më mori me vete ky trajtim regjisorial interesant i karaktereve shekspiriane, përndritur nga një vesk i thukët shqiptar: ku ata gëlonin mes gazmendit jo vetëm në kostume, dialekte, këngë e rite, por sidomos në dëshirën për ta sjellë këtë fantazi të bukur shekspiriane pranë njeriut shqiptar. Dhe vërtet ata rondokopë me sër Tobin e Guri Koços si Tobit bej që s'ngopet duke pirë e duke bërë prapësira, sër Endrjusin e Shkëlzen Berishës si një malok verior mburravec frikakak që i dridhet shpata në dorë, me Marien e Elona Hyseni si një Maro prej Çamërie, ato çifitanet e saj të gjelbra si thes, tejet qesharake, me energjinë dhe lojën e bukur; zhargonin çam, më tutje Lolua i Neritan Liçaj si shpotitësi i gjithëhershëm, llafazan sa dhe mençurak, që ikën e vjen sheshit të skenës duke hedhur fjalë të mençura e thumba të hidhur; dhe më në fund, ndofta më i realizuari si karakter e më pranë Shekspir (brenda stilit regjisorial), hermetik dhe snobi Malvolio i Mehmet Xhelilit si një Maliq katundi, mëtuës i dështuar i Olivias, me autoritetin e cenuar; i vënë në lojë paq nga shpura e sër Tobit. Ja dhe një zonjë shtëpie plot hir; vërtet fisnike dhe e dashuruar; por gjithsesi brenda kësaj habarie masive, Olivia e Rozi Kostantit dhe pak më tej aktorja e re Armela Demaj, që luajti hijshëm me ojat e "maskullit" nën petkat e femrës së veshur si burrë. Dhe këshut në vorbullën e gëzimit dhe epikurianizmit, shijës së jetës dhe aventurës çudane të fatit, tok me lojën e dashurisë ku e pamundura bëhet e mundur dhe gjithçka mbyllet në një gëzim të përgjithshëm krezmar nga drita, optimizmi dhe lumturia, - ja ku na erdhi kjo shfaqje e bukur; me një regji inventive dhe aktrim të zhdërvjellët plot energji, gjetje, karaktere, vrull e hare. Rafshi i dytë i idesë dhe zgjidhjes regjisoriale ishte afriame botën shqiptare, jo vetëm te kostumet kombëtare, më së shumti të periudhës së mesjetës (kostumi i jugut me fustanellë, aialab, ai malësisë së veriut me tirq e xhamadan, ai tiranas, ai myzeqar; veshja me dimi e gruas myslimane, veshja e

grave me fustane, jelekë, shami e kotoll të qëndisur; gjer dhe fustani fisnik i Olivias etj.). Afria ishte e dukshme, poashu, edhe sa i përket këngëve folklorike apo ato me saze prej një grup këngëtarësh e muzikantësh, në funksion të shfaqjes dhe episodeve të caktuara të saj, si dhe valleve, ritualeve festive, gjestit, dokeve, ku e gjitha kishte aromën e Shqipërisë. Në fakt, Shekspiri flet për Ilirinë, por regjisori e sjell në shekujt e mëvonshëm, kur etnia dhe kombi ynë si shqiptarë po formohej pikërisht nga ashta ilire. Një shfaqje plot hare, energji, lojë të bukur; Suksesse gjithë trupës së aktorëve që na fali një Shekspir ndryshe...

Opinion i Ditës

Përballë “Amerika First” dhe Europa e Bashkuar

Nga Vasil Kureta

(vijon nga faqja 1)

... “Amerika First”. Kjo ka nxitur analiza e opinione rreth përmbytjes, cilësisë, funksionimit të Perëndimit e rolit të tij në zhvillimet botërore, madje dhe për të ardhmen e tij, ku nuk mungon edhe një mendim apo dëshirë, që e quan Perëndimin një kapitull të mbyllur. Perëndimi i bashkuar, që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore e deri më sot ka rolin e tij të pazëvendësueshëm në zhvillimet botërore, në ruajtjen e paqes, stabilitetit dhe sigurisë, duke qenë modeli politik, ekonomik e social më i avancuar dhe për t'u konkuruar. Përballja e vendosur frontale me modelin e kampin komunist, dëshmoi edhe epërsinë e madhe, por dhe rolin e rëndësishëm të tij në zhvillimet botërore. Ishte një luftë e ashpër, që përveç përballjes ushtarake, konsumoi gjithçka për stabilitetin dhe paqen. Kjo përballje duket që e lodhi dhe e konsumoi në shumë drejtime Perëndimin, por që fituesi i meritoi të gjitha, duke siguruar një rol të dallueshëm qartë në zhvillimet botërore. Roli i Perëndimit dhe liderit të saj SHBA, kanë qenë vërtet të domosdoshme, efektive, racionale e të mirëprituara.

Brenda këtij ndryshimi historik në zhvillimet botërore, filloi të konstatohej të Perëndimi një “çlirim”, një eufori për fitoren mbi komunizmin dhe një lloj qetësie, shoqëruar me mendimin, se ne jemi fituesi, se ne do të udhëheqim e duhet të dëgjohejmë. Perëndimi u përpoq realisht të tregohet i kujdesshëm në ruajtjen e masës në këtë rol, në drejtim të zhvillimeve botërore, tekta u ngulmu në respektimin e ligjit ndërkombëtar, respektimin e bashkëpunimit me organizim të rëndësishëm ndërkombëtarë, por edhe me aktorë të rëndësishëm botërorë e rajonale. Megjithatë, gjatë kësaj kohe, pak u mendua të kthehej koka e vëmendja brenda vetes, për të vlerësuar konsumimet e menduar përsosjet e domosdoshme, për t'i dhënë frymëmarrje të reja funksionimit së brendshmi të Perëndimit, aq më tepër kur problemet kishin filluar të shfaqeshin. Kriza botërore financiare e vitit 2008, në një farë mënyre erdhi në momentin e duhur për Perëndimin, erdhi edhe si një tërheqje veshi, për t'u kthyer seriozisht nga vetja, për t'u marrë me veten, vetëpërsosur, për të zhvilluar më tej imunitetin ndaj sëmundjeve, goditjeve dhe sulmeve, që nuk po mungonin ndaj tij. Kur këto sulme e goditje u forcauan, u konstatua edhe tensioni e shqetësimi, por edhe një vetëqartësim për nevojën e kthimit seriozisht të vëmendjes dhe kokës nga vetja, nga ndryshimi dhe ripërtëritja e përmbytjes së Perëndimit. U konstatua se, nevoja për ndryshim e përsosje po zhvillohej më shpejt në raport me regjimin e mirëmenduar për përsosje.

Kjo situatë i hapri rrugë fenomenit që quhet si “grindja” brenda Perëndimit. Themi grindje për të kuptuar cilësinë dhe natyrën e



kontradiktave, problemeve e marrëveshjeve që kanë marrë udhë, të dallimeve, ndasive e interesave, jo vetëm të përbashkëta si perëndim, por edhe të atyre konkrete nacionale e shtetërore. Dalëngadalë, apo si të thuash pa u vënë re, u konstatua se, interesat e shtetit komb po zhvilloheshin fort e të bënin trysni, kryengritje, ndaj interesave të përbashkëta, integruese, perëndimore, madje dhe ndaj sistemit të vlerave, që përbën bazamentin, mbi të cilat është ngritur dhe funksionon modeli perëndimor. Ngarkesa ideologjike brenda Perëndimit, që nga rënia e komunizmit, kishte filluar të dobësohej, që ndikoi direkt në programimin e strategjive për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të vlerave dhe mbrojtjes efektive të tij, jo vetëm nga sulmet nga jashtë, por edhe nga goditjet tashmë edhe të brendshme, në formën e nacionalizmit, populizmit, sovranizmit, mbylljes etj., që mbnin brenda hapësirës së sistemit të vlerave e demokracisë funksionale.

Brenda BE kjo situatë u ushrye edhe nga një ngecje reale e avancimit të projektit European. Kjo rrethanë ka mundësuar tashmë që sistemi i vlerave të sfidohej edhe përmes formave të organizuara, sa i përket demokracisë funksionale, solidaritetit, sundimit të ligjit, raportit ndaj përgjegjësisë të përbashkëta ekonomike, politike, sociale, krizës së refugjatëve e problemit të emigrimit, që me vonesë u kuptua se po përdoret për interese imperiale edhe si armë gjeopolitike etj. Megjithatë, një problem serioz apo shqetësues aktualisht brenda Perëndimit lidhet me funksionimin e brendshëm të tij si të tillë, ku vëmendje të veçantë

paraqet përmbytja e marrëdhënies mes SHBA dhe BE, apo aleatëve të saj europianë. Presidenti amerikan Trump u shfaq transparent, por disi dhe jashtë traditës së mëparshme perëndimore, ku evidentoi, jo vetëm dallime, por dhe kontradikta e kritika konkrete ndaj aleatëve europianë, për probleme ekonomike, tregtare, por edhe të sigurisë. Kur presidenti amerikan Trump bëri publik tezën “Amerika First”, aleatëve europianë iu tërhoqi vëmendjen, por si të thuash e menduan si një filozofi politike në zhvillimin e rolit udhëheqës së SHBA në sistemin e marrëdhënies ndërkombëtare, që kishte të bënte me menaxhimin e rivalitetit e vëprimit nga Rusia e Kina, për ndarjen e fuqisë dhe rolit me SHBA. Në një farë mënyre u mendua se do të ishte një çështje kryesisht e SHBA, ku europianët do të ishin mbështetës. Në proces filloi të kuptohej se kjo filozofi do të përfshinte edhe rishikimin e “barazisë” brenda Perëndimit, duke i hapur rrugë më shumë kategorive ekonomike të fitimit, të tregut, të efektivitetit, të dobishmërisë për secilin vend. Dhe, në fakt, shpejt erdhën edhe opinione e vlerësime kritike të presidentit Trump, sa i përket partneritetit tregtar, kontributeve për sigurinë dhe funksionimin e NATO-s, në funksion të synimit për ta bërë atë sa më efektive. Tërheqja e SHBA nga marrëveshja për klimën, por sidomos më pas tërheqja nga marrëveshja bërthamore me Iranin, sikur i zgjoi e i shkundi aleatët europianë, të kuptonin se një ndryshim tashmë kishte filluar dhe po pasuronte përmbytjen e tij, që do të prekte shumë ekuilibra të vjetër, që kishin funksionuar.

Aplikimi i filozofisë “Amerika First” edhe brenda Perëndimit prek direkt marrëdhëniet bilaterale SHBA-BE, apo më saktë kërkon ndryshimin e revizionimin e saj. Jo vetëm kritikën ndaj aleatëve, por dhe veprime të tjera si vendosja e tarifave ndaj importeve të çelikut dhe aluminit, apo deklarimi i SHBA për tërheqje nga Këshilli i OKB për të drejtat e njeriut etj., dëshmojnë se ndryshimi po pasuron përmbytjen e tij edhe pse në kushtet kur duket një mungesë e konsultimit mes SHBA dhe aleatëve europianë. Ndoshta edhe nga kjo mungesë dialogimi paraprak për aplikimin e kësaj filozofie brenda marrëdhënies perëndimore, ka ndikuar në shfaqjen e një shqetësimi e tensioni mes europianëve apo në vlerësimin e këtij hapi si një politikë egoiste. Samiti i G7 dhe takimi i presidentit Trump me Kim Jong Un, siç u shpreh me sinqeritet Kancelarja gjermane Merkel, i bëri, apo kishte filluar t'i bënte “esëll” europianët, d.m.th. të kuptojnë qartë e të reflektojnë drejt përmbytjen e filozofisë politike të SHBA, tashmë edhe në raport me aleatët e vet natyrorë. Vërtet deri më sot BE bënte sikur merrej me veten, me ato deklarimet për “dy shpejtësitë”, me pohime “me shumë Europë”, apo me grindje të tjera, tash nevojitet një përqendrim e kuptim konkret të nevojës për përsosje të përmbytjes së marrëdhënies euroatlantike perëndimore.

Perëndimi me përballjen e tij me komunizmin dhe duke e mundur atë, në fakt, ndryshoi botën, rrjedhën historike dhe tani nevojitet të kuptojë se duhet të ndryshojë e përsosë vetveten, ta pasurojë më tej cilësinë dhe përmbytjen e marrëdhënies perëndimore. Shqetësimet e shfaqura apo

reagime e deklarime me tension, dëshmojnë se sa të papërgatitur kanë qenë në njohjen e nevojës për ndryshim të vetvetes, të kësaj nevojë historike. Këtë nevojë historike nuk mund ta përballojë e vetme klasa politike e një apo disa vende brenda Perëndimit. Nevojitet mirëorganizimi i një veprimtarie bashkëpunuese me kërkimin shkencor dhe në konsultim të pandërprerë me shtresat sociale e sidomos me brezin e ri, i cili duhet t'i japë fund një shkurtesjeje tronditëse për fatet e të ardhmes së vet. Nevojitet kështu një zgjidhje dhe kuptim i thellë e kompleks i situatës dhe nevojës historike që po pëqitet me shpejtësi. Ministri i Jashtëm gjerman H.Mass me të drejtë bën thirrje për integrim më të mirë të BE dhe për guxim, që dëshmon se po hyhet në brendësi të problemit që duhet përballuar. Të qëndruarit të bashkuar është vërtet element thelbësor, ndërsa guximi nevojitet për përballimin e sfidave të vështira e tepër komplekse. Askush nuk mund të përjashtohet nga angazhimi konkret, por dhe koncepti i pritjes nga dikush e të tjerët nuk mund të jetë efektiv.

Me vlerë të veçantë në përballimin e nevojës për ndryshim e përsosje të modelit e marrëdhënies perëndimore është orientimi i palëkundur nga sistemi i vlerave, nga mbrojtja e vendosur dhe sendërtimi i tyre, që do t'i mundësojë perëndimorët të fuqizojnë identitetin cilësor dallues nga të gjitha modelat e tjera. Sistemi i vlerave përbën çelësin, boshtin metodologjik, filozofik e politik për të ndëratur një program efektiv përsosjeje të modelit perëndimor e marrëdhënies brenda Perëndimit. Pa sistemin e vlerave nuk ka perëndim, nuk ka zhvillim të qëndrueshëm e cilësor ekonomik, politik e social. Ndryshimi e avancimi i përmbytjes e cilësisë së modelit perëndimor dhe marrëdhënies perëndimore, do të prekte të gjithë elementët. Kjo është arsyeja pse lindin shqetësime, tensione, por dhe keqkuptime fillëstare. Në këtë kuptim kërkesa për më shumë Europë, që vjen nga Gjermania, nënkupton sistemin e vlerave dhe nevojën për të qëndruar të bashkuar e për të kontribuar të gjithë në përballimin e kësaj nevojë të zhvillimit.

Në këto kushte, dallgë e ngritura të nacionalizmit, populizmit, apo të tërheqjes nga interesat e shtetit komb, janë një element negativ për harmonizimin e kontributeve e bashkimit e forcave krijuese, aq më tepër kur prej tyre shfaqet një frymë apo prirje për të relativizuar dokumentet apo traktatet shumëplanëshe. Ka një rëndësi të veçantë fati i projektit European dhe vetë BE, për Europën dhe për Perëndimin. Ngecja e avancimit të projektit u ka hapur udhë dhe mendimeve e supozimeve konkrete, siç është dhe ajo për mënyrën e funksionimit të

Opinioni **i** Ditës

Shqipëria, furnitorja më e madhe e Europës me hashash

"Zëri i Amerikës"

(vijon nga faqja 1)

... për Shërbimet e Antidrogës në Itali, e cila sapo ka publikuar "Raportin Vjetor" në lidhje me vitin 2017. "Importet e marijuanës në Itali janë rritur ndjeshëm, duke arritur në vitin 2017 një rekord të konfiskimeve, mbi 90 tonë nga rreth 41 tonë që ishin në vitin 2016", vlerëson raporti duke shtuar se "tendenca e konfiskimeve në Itali lidhet me kultivimin e marijuanës në Shqipëri. Raporti përmend rastin në 2017 "të konfiskimit më të madh të kryer ndonjëherë, në rajonin e Marche-ve, të barabartë me 8 tonë marijuanë, të cilat kishin si destinacion Europën Veriore".

Raporti i antidrogës italiane vlerëson se, "për më tepër klanet shqiptare kanë treguar se kanë një aftësi në rritje të menaxhimit në kultivimin e marijuanës dhe trafikimit të saj". Sipas dokumentit, ato përdorin bimë me rendiment të lartë dhe metodat gjithnjë e më të larmishme të fshesjes, kultivimit dhe transportimit në brigjet italiane. Nisur nga përmasat e trafikut, sipas raportit "grupet e krimt shqiptar konkurrojnë me organizata të tjera kriminale për kontrollin e pjesëve të rrugëve të trafikimit që arrijnë në Itali, si dhe për menaxhimin e rrjeteve të shpërndarjes së drogës". Nga të dhënat e raportit, shqiptarët zinin vendin e parë në rrjetet kriminale të huaja të narko-trafikut të përf-



shirë në trafikun e drogës me 25 nga 94 gjithsej. Pas tyre vijjnë rrjetet nga Gambia dhe Maroku.

Raporti vlerëson se 94 rastet e raportuara në vitin 2017 të trafikimit të drogës janë më të lartat në dekadën e fundit, ndërkohë që vlera më e ulët shënohet në vitin 2011, me 49 raste. Raporti i Antidrogës italiane vlerëson se, "rrugët e trafikut të drogës që çojnë drejt kufijve të shtetit italian mbeten të pandryshuara. Shumica e drogave të konfiskuara, afërsisht 95% u kapën jashtë vijës bregdetare, në ujërat territoriale dhe përgjatë kufijve detarë", vlerëson raporti.

Në zonat kufitare lidhur me

trafikun e marijuanës shënohet edhe numri më i madh i shqiptarëve të arrestuar, 41 persona nga 93 të huaj të ndaluar në kufijtë italianë përgjatë vitit 2017 me ngarkesa marijuane.

Por, grupet shqiptare nuk e kanë kufizuar aktivitetin e tyre vetëm në trafikun e marijuanës. Raporti i Antidrogës italiane shpreh shqetësimin se "së bashku me "Ndrangheta" në Kalabri, e cila falë një rrjeti kompleks të lidhjeve ndërkombe të tregut ka ende një rol kyç në trafikimin e kokainës në Itali, gjatë vitit 2017, dolën në pah, disa grupe të ashpra të krimt të huaj, të përbërë nga shtetas marokene, nigerianë dhe shqiptarë. Veçanërisht

këta të fundit, si dëshmi e një hapi cilësor në aftësitë e tyre operative, konkurrojnë me grupimet e tjera kriminale, kontrollin e segmenteve të rrugëve të trafikut në Itali dhe drejtimin e rrjeteve të shpërndarjes në territorin kombëtar të substancave kryesore narkotike".

Sipas shifrave të publikuara në raport, shtetasit shqiptarë vijnë të dytë në personat e huaj të arrestuar për trafik dhe shpërndarje të kokainës (me rreth 1.100 persona të arrestuar). Raporti vlerëson se nga 14.000 persona të huaj që janë përfshirë në vepra të drogës në Itali përgjatë vitit 2017, nga të cilët janë arrestuar më shumë se 10 mijë, rreth 2.000 persona kanë qenë nga Shqipëria.

Raporti i policisë italiane vë në dukje shtrirjen e aktivitetit edhe në Europë të grupeve shqiptare të cilat "renditen mes atyre më aktive, sa u përket mundësive operative, duke nisur nga aftësitë e kontrollit në fazën e zbarkimit dhe tërheqjes së furnizimit në portet holandeze dhe belge, të përdorura për futjen në Europë të kokainës, duke shfrytëzuar aftësitë e infiltrimit në strukturat logjistike dhe portuale të lëvizjeve të kontenerëve. Hetimet – sipas raportit – kanë dokumentuar organizimin kapilar të rrjetit të shpërndarjes së kokainës në territorin europian, që lidhet me organizata kriminale shqiptare, si dhe mundësitë e mëdha në mjete dhe persona që përdoren për këtë qëllim".

saj, siç është dhe mendimi që parashihet një "Europë e vjetër", "Europa e re" dhe ajo "Ortodokse". Kuptohet se rëndësi të veçantë ka modeli perëndimor i zhvillimit, i ngritur mbi sistemin e vlerave. Po kështu, një problematikë konkrete, që do të evidentohet dhe në këtë samit aktual në Bruksel, ekziston edhe sa i përket funksionimit të NATO, ku rëndësi të veçantë ka ruajtja e misionit të saj, sa i përket sigurisë, stabilitetit e paqes, mbrojtjes së modelit perëndimor të zhvillimit, qoftë në formën e mënyrën aktuale, apo në forma të tjera, ku nuk mund të përjashtohet edhe një strukturë europiane e mbrojtjes. Grindja apo problematika që shoqëron sot marrëdhënien SHBA-BE, në asnjë mënyrë nuk është tregues i gërryerjes apo konsumimit të Perëndimit. Në fakt, kontradiktat e brendshme e impulsjnë ndryshimin e përsosjen. Dhe historia e marrëdhënies perëndimore dëshmon qartë se kontradiktat e brendshme e zgjidhja e tyre e kompaktëson dhe e kanë bërë efektive funksionimin e Perëndimit. Natyrisht, në periudhën e përbaljes komplekse me komunizmin, kishte shumë më pak transparencë rreth tyre në dallim nga sot.

Edhe pse kontradiktat janë në

natyrën e çdo forme të gjallë, ka sot ndonjë që, nisur nga grindja aktuale brenda Perëndimit, mendojnë se SHBA rrezikon t'i kthejë shpinën Europës. Vëshirë të pranohet ky mendim, por edhe në se vërtet ndodh ndonjë ndryshim esencial i kësaj marrëdhënieje mes tyre, atëherë ai do të jetë tregues i një ndryshimi shumë të rëndësishëm në zhvillimet botërore. Historia e Perëndimit dëshmon qartë se zgjidhja e kontradiktave e ka kompaktësuar e pasuruar më tej marrëdhënien perëndimore. Ka shumë rëndësi të shmanget shpërndarja apo kriza ideore rreth projektit europian, por dhe shtrahitimi i një dialogu të menduar mirë mes BE dhe SHBA, për të shqyrtuar me përgjegjësi problematikën e grumbulluar në marrëdhënien perëndimore. Në këtë situatë ka sot edhe faktorë e aktorë të ndryshëm që u intereson shumë, jo thjesht grindja brenda Perëndimit e thellimi i saj, por edhe një çarje përfundimtare dhe e vërtetë e Perëndimit. Natyrisht, kjo situatë u intereson aktorëve si terrorizmi etj., që kërcënojnë seriozisht stabilitetin, paqen e sigurinë në botë e rajone konkrete. Kjo grindje e çarje definitive e Perëndimit u intereson dhe inter-

esave konkrete imperiale të rolit botëror e rajonal. Kina dhe Rusia realisht rivalizojnë me SHBA për rol botëror dhe ndarje të fuqisë me të. Në këtë pozicion ato lëvizin të shfrytëzojnë çdo hapësirë të mundshme që krijon kjo grindje perëndimore. Kështu Kina e ndodhur përballë një lufte tregtare me SHBA, e mendon një grupim të saj me BE, apo me disa vende europiane për të përballuar luftën tregtare, por edhe për të forcuar rolin në zhvillimet botërore. Po kështu Rusia, që tashmë hapur rivalizon me SHBA në pozicionin e fuqisë botërore, ka interesa e objektiva të qarta gjeo-strategjike e synime rreth Europës, por që ka dhe interesa të rëndësishme ekonomike në këtë hapësirë. Rusia duket se e mendon dhe e beson vërtet, kur përcjell tezën përmes Lavrov se "jemi duke jetuar krijimin e rendit të ri botëror post perëndimor". Edhe më parë është përcjellë një tezë e tillë, por e risjellë tani në këtë situatë, në prag të samitit të NATO, por edhe në prag të takimit të afërm Trump-Putin ka domethënie konkrete, sa i përket prishmërive ruse ndaj grindjes perëndimore dhe takimit të Helsinkit. Lavrov, jo rastësisht referohet interesit të bashkëpunimit ekonomik e tregtar me

BE, duke mos harruar të flasë për rol dominues të SHBA brenda Perëndimit.

Në samitin e Helsinkit do të ketë realisht një përballje mes "Amerika First" dhe "Rusia First", që në këto kushte nuk mund të mos i shqetësojë europianët. Ka shumë të ngjarë që Perëndimi të përballlet me një trysni apo luftë komplekse të ftohtë nga aktorë që kanë e zhvillojnë interesa imperiale e të superfuqisë botërore. Samiti i NATO-s dhe takimi i Helsinkit mes Trump dhe Putin, do të sqarojë shumë shqetësime e pikëpyetje të lindura jo rastësisht. Në prag të këtyre zhvillimeve, jo rastësisht, vjen dhe një deklaratë shumë e qartë e zyrtarit të lartë amerikan Mitchell, ku nënvizohet se "Ne kërkojmë marrëdhënie të mira me Rusinë, por kjo mund të ndodhë vetëm kur Rusia të ndalë sjelljen e saj agresive. Ne nuk bëjmë kompromis me parimet tona apo aleatët tanë. "Siç ka theksuar edhe sekretari Pompeo, "vitet e politikës së butë që mundësojnë agresionin rus kanë marrë fund. Ne do t'ia risim kostot agresionit rus deri sa presidenti Putin të zgjedhë rrugë të ndryshme".

Më 11 korrik 2018

HOROSKOPI

DASHI

Kanë të drejtë të urtë, kur ata thonë se puna të ngushëllon. Sidomos kur ndërmerr veprimtari krijuese, që ju e pëlqeni dhe ju jep kënaqësi. Kush-tojni rëndësi edhe kohës së lirë, duke u marrë me gatime, vallëzim ose gjëra të tjera që ju pëlqejnë.

DEMI

Do të keni romancë dhe krijimtari, me Hënë dhe treshen Diell-Mërkur-Neptun që ju mbështet. Duke ndjekur intuitën tuaj, nuk mund të gaboni. Partneri dhe miqtë do t'ju kushtojnë vëmendje të veçantë dhe ju ndjekin në veprimtarinë tuaj të shumëllojshme.

BINJAKET

Do të keni dëshira dhe ndjenja që do t'i mbani të kyçura, sidomos për ata që zemërnë nuk e kanë plotësisht të lirë dhe ndoshta edhe jo të çlirueshëm! Dashuri platonike dhe të pashprehura për beqarë, shumë të ndrojtur apo të pasigurt për t'u shprehur.

GAFORJA

Në punë do të jeni të zotët. Me gjakftohtësi do të menaxhoni punët dhe situata të ndërlikura edhe në distancë. Lërgpamësia dhe analiza juaj do të përkthejë kudo! Keqkuptimet në çift do të mund t'i sqaroni me një vend romantik, larg nga stresi i përditshëm.

LUANI

Dita është e mbushur me pengesa, duke filluar me Hënë që përballlet me Plutonin, i cili ka edhe prirje armiqësore. Të pakënaqur në të gjitha frontet! Nuk keni asnjë mbështetje nga planetët e tjera, madje edhe Venusi ju anashkalo.

VIRGJERESHA

Do të keni krijimtari të fuqishme. Në udhëtime u bëni edhe më të hapur dhe veprimtaria që ndërmerrni është e mbushur me fantazi. Me partnerin nuk do të kufizoheni duke folur vetëm për dashurinë: tema e parapëlqyer preferuar nisnin nga muzika e deri në tërë piktura.

PESHORJA

Të ndiheni të mërzitur ju prek në sedër, tashmë që Hëna po ju ndjek në heshtje, pa ngritur edhe një gisht në favorin tuaj. Përkushtimi i saj është i mbajë të mbyllura me çelës emocionet, ndjenjat si edhe ndoshta një dashuri të fshehtë. Në çift njëri nga të dy bën pak si tekanjok, ndoshta ju, por vetëm për argëtim.

AKREPI

Në çift njëri nga të dy bën pak si tekanjok, ndoshta ju, por vetëm për argëtim. Kujdes, partneri është duke u vëzhguar, i gatshëm për t'jua kthyer me të njëjtën monedhë. Hëzozia bren në zemër dhe të mbani emocionet nën kontrollin bëhet më e vështirë.

SHIGJETARI

Do të keni tensione në çift. Është e vërtetë se Venus është në anën tuaj, por sot është në konflikt me Hënë. Gjërë konkrete do t'ju ndihmojnë në punë. Do t'i kushtoni vëmendje çështjeve financiare dhe si gjithmonë çdo projekt ka nevojë për një sponsor.

BRICJAPI

Me një atmosferë romantike dhe poetike Hëna në shenjë ndryshon të gjitha sferat e jetës, nga dashuria tek puna, nga ëndrra në realitetin e përditshëm. Treshja Diell-Mërkur-Neptun e bën çdo gjë më të bukur, duke ju përmëshur emocionalisht.

UJORI

Lidhja ka nevojë për një pauzë për të reflektuar: kur duke planifikuar të ardhmen mendon më shumë për të kaluarën, kjo do të thotë se diçka duhet të ndryshojë. Pak të motivuar dhe të jo shumë të qetë në rutinën e punës, nuk jeni të qartë dhe nuk tregoni as edhe durimin më të vogël.

PESHQIT

Do të keni shumë krijimtari dhe aftësi komunikuese. Do t'i shikuarin vazhdimisht një mikut të largët, dhe mesazh pas mesazhi, distanca nuk do të ndihet më. Do të keni fat me ndërmarrje dhe kontakte me vende të huaja, të favorizuar nga njohja e mirë e gjuhëve të huaja.

Kualifikimi i Francës për në finalen e madhe të 15 korrikut është pritur me entuziazëm të jashtëzakonshëm nga parisienët, që kishin mbushur "Champs Elysees" për të ndjekur gjysmëfinalen ndaj Belgjikës e më pas për të festuar fitoren e merituar pas golit të shënuar nga Samuel Umtiti. Një ndeshje që riktheu Francën në finale pas 12 vitesh mungesë, një



Kualifikimi i Francës festohet dhe ekzagjerohet nga tifozët

Parisi në festë, Parisi në luftë!

ndeshje që i hap derën betejës për trofeun e dytë botëror: Dhe Parisi ishte në festë. Qindra mijëra tifozë, nëpër rrugë, nëpër sheshe. Përgëndrimi më i madh në rrugën më të famshme të planetit, bulevardi "Shon's Elize", që lidh me gjatësinë e saj dy prej shesheve kryesore të

kryeqendrës franceze, "L'Arc de Triomphe" dhe "Place de la Concorde". Një bulevard që zakonisht ka qenë epiqendra e revolucioneve më të mëdha të historisë, dhe ishte epiqendra e festës. Një festë legjitime, një gëzim i madh për të gjithë ata që e duan futbollin dhe që e përjetojnë atë.

Por kjo ishte pjesa e ngjëllore e Parisit, festa shumëngjyrëshe e etnive! Pjesa e errët mbuloi qytetin menjëherë pas gëzimit të shfrenuar. Tifozë që përleshën mavisht me tyre si dhe përplasje të dhunshme me policinë. Gjithçka e nisur nga ata që Parisin nuk e shohin

dot si një kryeqendër globale, por si një pronë krejtësisht e të francezëve. Ndoshta përplasje me bazë etnike. U hodhën flakadani shklopinj e gurë ndaj policisë, me forcat e rendit që u detyruan të përdornin gazin lotsjellës për të shpërndarë turmat e acuruara. Shpesh harrojmë se futbollit është festë sportive, futbollit bashkon dhe kështu duhet të jetë gjithmonë.

Anglia shënon me Tripier, por Perisic dhe Manxukic realizojnë përmbyjsjen për Kroacinë

Kroaci përrallore, eliminon Anglinë dhe shkon në finale

Dalic realizon ëndrrën e Shukerit me shokë

Jeton Selimi

Kroacia në finale! Kroacia e 4 milionë banorëve bën mrekullinë e madhe, atë mrekulli që tentoi Shuker me shokë 20 vjet më parë. Tashmë ëndrra e një populli u bë realitet. "Komandanti" Dalic dhe "ushtarët" e tij gjuhëzojnë Anglinë dhe shkojnë në Moskë, aty ku i pret Franca, pikërisht ajo Francë që në vitin 1998 u ndërpreu rrugën kroatëve pas dygolësht të Liliam Turam. Të dielën është koha për hakmarrje! Anglia e nis me shpërthim! Shpërthim i ardhur nga precizioni balistik i Kiran Tripier, që nga goditja e dënimt thyen Subasic me një gol të shkëlqyer, një gol që është kurorëzim i një Botërori prej protagonistit. Anglia vijon të dominojë dhe i shkon pranë dyfishimit me Meguajër, por gjuajtja e tij me kokë del për pak jashtë. Kroacia shfaqet në të 19-ët, por gjuajtja e Perisic nuk shqetëson Pikfordin. Kejn ka në këmbët e tij golin e dytë, por shpërdoron në mënyrë të pabesueshme epërsinë e ishullorëve. Kroacia nuk arin të prodhojë në sulm, ndërsa provon vetëm me gjuajtje nga jashtë zonës, por Pikford është i vëmendshëm. Sërisht Anglia ka në dorë mundësinë për ta mbyllur pjesën e parë në avantazh të dy golave, por Lingard gjuan keq nga pozicioni i favorshëm. Pjesa e dytë do të nisë më e qetë, madje kalon shumë minuta përpara se të kemi një rast të mirë goli. Në fushë ka nervozizëm. Anglia nuk sulmon më në si në pjesën e parë, ndërsa Kroacia nuk kërcënon seriozisht portën e Pikfordit. Deri në minutën e 68-të, kur Perisic devijon saktë me këmbë harkimin e Vërljaskos, duke mposhtur gardianin anglez. 1-1 dhe është Kroacia ajo që beson tani. Në minutën e 72-



të zoti i futbollit është me Anglinë, kur Perisic ndalet vetëm nga shtylla, ndërsa në tentativën e dytë, Pikford e sheh topin në duar. Provon edhe Brozovic pak sekonda më pas, por gjuajtja e tij fluturon pa koordinatë. Kroacia vijon të imponojë ritmin e saj, ndërsa anglezët duket se pranojnë në heshtje barazimin. Manxukic thërret sërisht në detyrë Pikfordin, ndërsa me topin e mbetur vakant,

Perisic ka mundësinë e parabolës, por e gjuan topin më fort se ç'duhet. Në fund të ndeshjes, në zhvillimet e një këndoreje, Kejn mund ta mbyllte ndeshjen, por gjuan keq me kokë. Ndeshja shkon në shtesë, e treta radhazi kjo për Kroacinë, e dyta për Anglinë pas Kolumbisë. Zilen e parë e con Anglia në minutën e 99-të, kur rrugën e golit gjuajtjes së Stouns ia ndërpret Vërsaljko mbi linjën fatale.

Në fund të shtesës së parë, Pikford bën një tjetër mrekulli, kësaj radhe ndaj Manxukicit, që devijon drejt portës, por këmba e portierit e nxjerr topin në këndore. Skuadrat ndërrojnë fushat dhe nisin shtesën e dytë prej 15 minutash, ndërsa Kroacia nis presingun. Në minutën e 108-të Brozovic gjuan rrjetën e jashtme nga një pozicion ideal, ndërsa 60 sekonda më pas, Manxukic harrohet në zonë nga mbrojtja kroate dhe me gjakftohësi mposht Pikfordin, duke çuar peshtë pjesën bardhekuqe të stadiumit. Kramariç kishte golin e knok out-it në minutën e 120-të, por në vend që të pasojë, gjuan rrjetën e jashtme. Anglia është e dëshpëruar dhe në dëshpërim nuk arrijn dot të logjikoje, ndërsa turku Çakër vërshtëllen tri herë, duke legjitimuar festën e Kroacisë, e cila arrin kështu të shkruajë një faqe të rëndësishme të historisë së saj dhe ka mundësinë që ta kulmojë atë më 15 korrik në Moskë kundër Francës.

SHKURT

Kukësi ngec me Valetën, Frashëri i shpëton fytyrën

Me siguri ndikuan shumë gjëra: ndeshja e parë e sezonit, të nxehtit, ndryshimet e shumta në merkato, mosnjohja e kundërshtarit... Megjithatë, një barazim 0-0 në vajtjen e turit të parë në Champions League është pa asnjë dyshim një zhgënjim i madh për Kukësin. Duhet fitore, nuk erdhi; duhej lojë, nuk ishte gjekundi. Me Peter Pakullt ishim mësuar ndryshe, por ndoshta presioni i Europës ishte tepër i madh. Kukësi bëri pak ose asgjë, largimi i Gurit në sulm la një gropë të madhe dhe Plaku nuk e bën dot pykën, sado të vrapojë, sidomos kur nuk ka hapësira në mesfushën kundërshtare. Valeta mund të mendojë inferiore, por sot luajti shumë mirë, kontrollioi fushën në çdo cep, krijoi edhe raste të shkëlqyera për gol dhe në fund mori atë që donte, një barazim. Natyrisht, 0-0 nuk është kurrë rezultat i keq, por shqetëson loja e dobët e Kukësit, që në Shkodër u duk jetim, me shumë pak tifozë nga pas dhe një ritëm mjaft të ulët.

Gega: Duhet kujdes me Mariborin

Trajneri i Partizanit, Skënder Gega, ka shpresa se skuadra e tij mund t'ia dalë përballë Mariborit nesër. Në konferencën për shtyp ai ka folur edhe për lënien jashtë të Edgar Çanit, si dhe për objektivat që ka për të ardhmen. "Shorti nuk është i lehtë, por ky ishte fati ynë, edhe pse në fakt do të donim një rival tjetër. Maribori është skuadër shumë e fortë dhe ka një ecuri të jashtëzakonshme vitet e fundit. Unë jam i kënaqur me grupin dhe kam besim se do të bëjmë më të mirën për një paraqitje sa më dinjitoze. Ne duhet të jemi të kujdesshëm për të gjitha gjërat në fushë. Duhet të jemi gati si në sulm, ashtu edhe në mbrojtje", tha fillimisht trajneri. Gega thotë se lënia jashtë e Çanit ka qenë vendim kryeqëndësues i tij dhe se është thjesht çështje teknike. "Çani ka qenë pjesë e grupit dhe unë isha në dijeni. Parametrat e Çanit nuk janë aty ku duhet. Sot për sot ai nuk plotëson parametrat për të kontribuar. Gjithsesi, ai ka kontratë dhe është pjesë e klubit. Por unë po ju them se kam shumë pak kohë në dispozicion dhe dua të ndërtoj sa më shpejt një grup të fortë. Vendimi për lënien jashtë të tij (Çanit) ka qenë teknik. Po ju them se jam unë, personi që ka vendosur që ai të mos jetë i përfshirë në 20 lojtarët për këtë tur, arsyet janë teknike. A do të bëjmë përfორime? Partizani ka nevojë për përfორime që bëjnë diferencën. Klubi ka politikën e vet dhe mund të them se bjeret nuk janë në dorën time. Megjithatë, jam i kënaqur me këta që kanë ardhur deri tani", deklaroi Gega.

Pretendentja e vetme që plotësoi prishmëritë

Armata e Dëshamp, gati të "pushtojë" Rusinë

Gjelat" nisin këngën në Rusi, pasi sot më shumë se kurrë besojnë se ky është turneu i duhur për të rikthyer sërisht në majën e futbollit botëror. Armata e Didre Dëshamp zbarkoi në Rusi me një formacion yjesh, përfaqësuesja më e shtrenjtë në Botëror dhe ky vlerësim po tregon se është korrekt, fundja Franca është shembulli tipik ku vlera përkethehet dhe në rezultat. Ndryshe nga përfaqësuesja

e tjera, të cilat konsideroheshin favorite, trikolorët janë të vetmit që respektuan prishmërinë, arritën të prekin finalen e madhe, pasi likuiduan edhe Belgjikën. Kjo është hera e tretë që Franca arrin finalen në 6 Botërorët e fundit, kjo falë një goli të Umtiti, i cili bëhet mbrojtësi i tretë që shënon në këtë Botëror, për herë të fundit kjo ka ndodhur në 1998, ku Franca arriti të shpallej kampion. Trajneri Dëshamp ka në dispozicion


një grup shumë cilësor, ku nuk mungojnë as talentet si Mbape, por as lojtarë ekspert si Grizman, dy futbollistë të cilët po lënë gjurmë në këtë Botëror. Ylli i Paris Sën Zhërmen ka realizuar 15 driblime në 6 ndeshje, nga ku 7 ka arritur t'i realizojë, një statistikë e cila qëndron te në fuqi që nga viti i largët 1966. Aftësitë tribluese të Mbapes mbi të gjitha me topin në këmbë janë mbresëlënëse, po ashtu shpejtësia e tij, por ai i cili po bën



liderin në një formacion të mbushur me gela është Antuan Grizman. Pavarësisht se biondi nuk arriti të shëronte në gjysmëfinalen kundër Belgjikës, Grizman shkeli në ddo cep të fushës. Me 6 gola në shtatë ndeshjet e fundit me eliminim direkt, Grizman është lojtari më efikas në his-

torinë e Francës kur gjërat bëhen serioze. Një meritë të padiskutueshme për kualifikimin historik të Francës, ka trajneri Didier Dëshamp. Kjo është finalja e dytë e madhe radhazi pas "Euro 2016", hera e parë për një trajner që e arrin dicka të tillë në historinë e Francës.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Dillon aktor.
5. Një listë që zgjidhet nga regjisor
9. Sigla e tritolit.
12. Kapiteni që ndiqte balenën Moby Dick.
14. Eshhtë spektator i yni.
16. Fillojnë lejen
17. Një sinjal akustik.
19. Një parashetëse për... përtej.
20. Eshhtë partia e Sali Berishës.
23. Kanë organizatën Hamas.
24. Gëlojnë nga murgjit.
25. Në teori kur mungon ti.
27. Inicialet e Gide.
28. Inicialet e Asimov.
29. Nisen pa ne.
31. Kreshniku i volejbollit.
36. Kufijtë e tokës.

37. Mund të jenë autonome të tilla.
38. Britma e Arkimedit.
41. Fillojnë vetëm.
42. Bota jashtë ëndrrës.
44. Mund të jenë ushtarake.
46. Italia në Internet.
47. Gjysmë atomik.
49. Janë prova inteligjence
50. Një libër hartash.
51. Clapton i muzikës.

VERTIKAL

1. I famshëm ai i Trojës.
2. Një... bombë tenistike.
3. Fillojnë themelet.
6. Mund të jetë klasifikimi.
7. Një letër... kampioni.
7. Eshhtë pozicioni për gjumë.
8. Janë diktatorët despotikë.
9. Një kryeqytet afrikan.
10. Qe mesfushor i famshëm i Ajax.
11. Ekstreme në tenis.
13. Eshhtë e dendur në xhungël.

15. Eshhtë brinjë në skuadër.
18. Eshhtë pako që dërgohet.
20. Brown i Kodi i Da Vincit.
21. Bëjnë taktika me taka.
22. Vetot pa kufij.
23. Persekutonin romakët.
24. Eshhtë gri ajo e trurit.
26. Një mund të jetë spiunzhi.
30. Janë vendet për nisje.
32. Me to bëjnë torta.
33. Janë katër në kitarë bas.
34. Institucione Urbane Rajonale.
35. Priten me lotë në sy.
39. Një rreth pa ekstreme.
40. Gjysmë kasate.
41. Eshhtë cilësia.
43. Ente Tregtare Lokale.
45. Një pjesë e territorit.
48. Në hyrje të oazit.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Jagger i Rolling Stones.
4. Zanore për kuaj.
6. Janë dhelpra.
11. Inicialet e Lendl ish tenis.
12. Kufizojnë rastet.
14. Mbyllen me epilog.
16. Eshhtë simbol ngadalësie, por jo breshkë.
18. Gjysmë njeriu.
20. Janë fruta ekzotikë.
21. Një minierë e vjetër.
23. Ata tanë ishin ilirë.
24. Masat pa kufij.
25. Një gëzim i madh.
26. Agjenci Ndërmjetëse Përmet
27. Eshhtë godinë në miniaturë
29. Film i Ridley Scott
31. Duken të gjata në pritje.

32. Njëzetmijë... në det në një libër të Jules Verne.
34. Eshhtë kreu i bandës.
36. Ndahen nga ortakët.
38. Eshhtë numri një.
41. Janë trupa qiellore të tillë.
44. Kanë dhoma për t'u zënë.
46. Tri çupa në poker.
47. As unë, as ai.
48. Janë vitet.
49. Pak amatoriale.


VERTIKAL

1. Një legjendë.
2. Përfundojnë një stil.
3. Nuk e ulin kokën.
5. Këndohen në opera.
6. Janë tek në Somali


7. Eshhtë lloj papagalli.
8. Mbyllin komentin.
9. Eshhtë e parë për prodim.
10. Kush ka do të pijë.
13. Janë binarë.
15. Rolet pa ret.
16. Vihen për të mbyllur të tilla.
17. Janë tek në mantel.
19. Salgari që krijoi Sandokan.
20. Një stinë e ngrohtë.
22. Janë pamje nga puna.
26. Një fjalë goxha.
27. Ato Èilliams janë teniste
28. Ishin të parët tanë.
29. Janë edhe ato polare.
30. Fillojnë nazet.
33. Inicialet e Triolet.
36. Një bëhet me pozë.
37. Mbyllin punimet.
39. Ndoth në kufij.
40. Perignon i champagne-s.
42. Eshhtë iks ajo e sulmit.
43. Enti europian i hapësirës.
45. Fillojnë lehtë.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

			7			9		
	5	9			8	4		1
4					5		6	8
	9			5		6		4
		6				8	3	
9	4		1					
3			7					2
6			9	3				

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

4	5	1	3	6	8	2	7	9
8	7	2	9	1	4	6	3	5
6	9	3	5	7	2	4	8	1
7	2	6	4	9	5	8	1	3
5	1	4	8	3	6	7	9	2
9	3	8	7	2	1	5	6	4
1	4	9	6	5	7	3	2	8
2	6	5	1	8	3	9	4	7
3	8	7	2	4	9	1	5	6

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Nëse nuk shikoni atje ku doni të shkoni, atëherë, do të shkoni atje ku ju shikoni.

- Mënyra për të jetuar më mire dhe më i patrazuar është ajo e mendimitarit, sepse, që ta themi pa e zgjatur atë që ka rëndësi, ai ka më shumë nevojë për gjërat që të tjerët i përcmojnë dhe i braktisin.

Thënie të mençura

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

12	S	A	15	F	8	14	4	14	4	7	4	15
4	11	4			1	8	12	2	3	14	5	10
10		1	4	1	2	8	10	6	4	7	5	
4	7		1	7	5	8	9	4	2	10	4	
15	3	1	6	2	10	5	2	6			12	
7	1	11	13	5		1	5		17	15	1	
17	3	10	13	3		4	4		4	10	6	3
4		2	4	7		11		6	10	4	2	4
12	1	5	16	4	10	5		4	4	8	16	
14	4	7	4		8	14	5		17	3	10	10
4	11	4	7	6	2	6	1	5		7	5	4
2	4	2	5		2	1	2	8	10	6		2

- tek vetja jote që të jetë e denjë për t'u dashur.
- - Ju qeshni me mua sepse unë jam ndryshe. Unë qesh me të gjithë ju që jeni të njëjtë.

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

